



Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, të Ligjit Nr. 03/L-209 të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.77 / 16 Gusht 2010), dhe nenet 19 dhe 85 të Ligjit Nr. 04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jo-Bankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.11 / 11 Maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore, në mbledhjen e mbajtur më 28 shkurt 2023 miratoi këtë:

## **RREGULLORE PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT TË LIKUIDITETIT TË BANKAVE**

### **KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të përcaktojë standardet dhe kërkesat minimale për menaxhimin efektiv të rrezikut të likuiditetit nga bankat.
2. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha bankat dhe degët e bankave të huaja të licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës, të referuara në vijim me bankat.

#### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termat e përdorura në këtë rregullore kanë kuptim të njëjtë me Nenin 3 të Ligjit Nr.04/L-093 për Bankat, Institucionet Mikrofinanciare dhe Institucionet Financiare Jobankare (në vijim: Ligji për Bankat) dhe/ose sipas përkufizimeve në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
  - 1.1. **Mungesë likuiditetit** – nënkupton çdo situatë, kur banka:
    - 1.1.1. nuk posedon asete të mjaftueshme likuide ose ballafaqohet me vështirësi për të siguruar ato në treg, me qëllim të përmbushjes së detyrimeve kur ato maturohen dhe për të përmbushur ndonjë kërkesë të paparashikuar të fondeve nga depozitorët e saj dhe kreditorët tjerë;
    - 1.1.2. nuk ka mundësi të financojnë rritjen e aseteve;
  - 1.2. **Rreziku i likuiditetit** – nënkupton mundësinë e humbjes financiare si rezultat i mungesës së likuiditetit;
  - 1.3. **Kushtet/situata jo të zakonshme** – nënkupton ato situata në të cilat ekziston një kërcënim real që mund të sjellë bankën në mungesë të likuiditetit;

- 1.4. **Plani rezervë i likuiditetit** – nënkupton dokumentin e hartuar nga banka, në të cilin qartësisht pasqyrohen politikat dhe procedurat që duhet ndjekur në kushte jo të zakonshme, si dhe procedurat për sigurimin e fondeve të emergjencës;
- 1.5. **Rrjedha neto e parasë** – nënkupton diferencën në mes rrjedhjeve hyrëse dhe dalëse të parasë për një periudhë të caktuar kohore, duke reflektuar në rritje apo ulje të sasisë së parasë;
- 1.6. **Maturiteti kontraktual i mbetur** – nënkupton periudhën kohore të mbetur deri në përfundimin e afatit të maturimit të aseteve dhe detyrimeve kontraktuale;
- 1.7. **Koncentrimi në burimet e financimit** – nënkupton situatën kur një vendimmarrje e vetme ose një faktor i jashtëm i vetëm mund të shkaktojë tërheqje të menjëhershme dhe të konsiderueshme të fondeve, duke detyruar kështu bankën të ndryshojë ndjeshëm strategjinë e saj të financimit;
- 1.8. **Stres-testi** – nënkupton teknikën e menaxhimit të rrezikut për të vlerësuar ndikimin e mundshëm të një apo më shumë faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm mbi qëndrueshmërinë financiare dhe/ose pozicionin e likuiditetit të bankës;
- 1.9. **Depozitorët e mëdhenjë** – konsiderohen njëzet depozitorët me shumën më të madhe të depozitave në totalin e depozitave të bankës;
- 1.10. **Hendeku i likuiditetit** – është diferenca në mes të aseteve dhe detyrimeve të bankës, sipas intervaleve të maturitetit;
- 1.11. **Shkurtimet (Haircut)** – është përqindja me të cilën vlera e aseteve likuide është zvogëluar për qëllime të përlogaritjes së treguesit të likuiditetit, në përputhje me përcaktimet e kësaj rregulloreje.

## **KAPITULLI II**

### **SISTEMI I MENAXHIMIT TË RREZIKUT TË LIKUIDITETIT**

#### **Neni 3**

##### **Sistemi i menaxhimit**

1. Banka është përgjegjëse për menaxhimin e shëndoshë të rrezikut të likuiditetit.
2. Banka duhet të krijojë një kornizë të qëndrueshme të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit për të siguruar mbajtjen e likuiditetit të mjaftueshëm, duke përfshirë rezervën e aseteve likuide të cilësisë së lartë, të lira, për të përballuar disa ngjarje stresi, duke përfshirë ato ngjarje që përfshijnë humbjen apo përkeqësimin e burimeve të financimit të pasiguruara dhe të siguruara.
3. Banka duhet të krijojë një kornizë të qëndrueshme të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit që është e integruar mirë në procesin e menaxhimit të rrezikut në të gjithë bankën.
4. Objektivi primar i kornizës së menaxhimit të rrezikut të likuiditetit duhet të jetë sigurimi i një niveli të lartë të besueshmërisë që banka është në një gjendje të adresojë detyrimet ditore të likuiditetit dhe të përballojë një periudhë stresuese të likuiditetit që ndikon në financimin e siguruar dhe të pasiguar, burimi i të cilës mund të jetë i shkaktuar nga vetë banka ose nga tregu në përgjithësi.

5. Përveç mbajtjes së qeverisjes së shëndoshë dhe praktikave të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, banka duhet të mbajë një rezervë adekuate të likuiditetit të përbërë nga asete të tregtueshme menjëherë për të qenë në gjendje për të përballuar periudhat e tilla stresuese të likuiditetit.
6. Banka duhet të dëshmojë që rezerva e likuiditetit të saj është në përputhje me kompleksitetin e aktiviteteve bilancore dhe jashtëbilancore, likuiditetin e aseteve dhe detyrimeve të saj, shkallën e mospërputhjeve të financimit dhe me shumëllojshmërinë e veprimtarive dhe strategjive të financimit të saj.
7. Banka duhet të përdorë supozime të përshtatshme konzervatore rreth tregtueshmërisë së aseteve dhe të qasjes së saj në financim, të siguruar dhe të pasiguruar, gjatë periudhave të stresit. Për më tepër, banka nuk duhet të lejojë që presionet konkurruese të komprometojnë integritetin e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit të saj, funksioneve të kontrollit, sistemet e limiteve dhe rezervës së likuiditetit.
8. Banka krijon një sistem për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, i cili ka për qëllim menaxhimin e mirë të rrezikut të likuiditetit të tyre. Bankat sigurojnë që sistemi i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit, në mënyrë sasiore dhe cilësore, të jetë në përputhje me madhësinë e bankës, llojin e aktivitetit dhe nivelin e ekspozimit ndaj rrezikut të likuiditetit.
9. Sistemi i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit përmban elementet minimale si në vijim:
  - 9.1. strategjinë dhe politikat e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
  - 9.2. strukturën organizative për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit;
  - 9.3. sistemin e kontrollit të brendshëm;
  - 9.4. sistemin e menaxhimit të informacionit;
  - 9.5. stres testi i likuiditetit;
  - 9.6. plani rezervë i likuiditetit.

#### **Neni 4**

##### **Struktura organizative, detyrat dhe përgjegjësitë për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit**

1. Struktura organizative e përshtatshme për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit duhet në mënyrë të qartë të përcaktojë kompetencat dhe përgjegjësitë e organeve të bankës dhe të definojë detyrat dhe përgjegjësitë e pjesës organizative përkatëse në bankës, të autorizuar për monitorimin e likuiditetit të bankës dhe menaxhimin e rrezikut të likuiditetit.
2. Bordi i Drejtorëve i bankës, në lidhje me menaxhimin e rrezikut të likuiditetit është përgjegjës që të:
  - 2.1. aprovojë strategjinë e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
  - 2.2. aprovojë politikat e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit dhe monitorojë zbatimin e tyre duke përfshirë aprovimin dhe monitorimin e planit rezervë të likuiditetit;
  - 2.3. rishikojë përshtatshmërinë e politikave dhe procedurave, në fuqi, së paku në baza vjetore;
  - 2.4. rishikojë raportet e rrezikut të likuiditetit;
  - 2.5. aprovojë limitet e ekspozimeve të rrezikut të likuiditetit;

- 2.6. monitorojë efikasitetin e kontrollit të brendshëm, si një pjesë integrale e sistemit të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.
3. Komiteti i Menaxhimit të Rrezikut është përgjegjës që të:
  - 3.1. monitorojë politikat e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit dhe të jap propozime për rishikimin e tyre;
  - 3.2. vlerësojë sistemin e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
  - 3.3. analizojë raportet e ekspozimit të rrezikut të likuiditetit të bankës dhe monitorojë menaxhimin e rrezikut;
  - 3.4. përcaktojë dhe periodikisht rishikojë treguesit e brendshëm të likuiditetit dhe limitet e ekspozimeve të rrezikut të likuiditetit;
  - 3.5. përcaktojë përjashtimet e mundshme nga limitet e përcaktuara dhe të caktojë përgjegjësit për zbatimin e këtyre përjashtimeve;
  - 3.6. krijojë procedura dhe metoda për kryerjen e stres test-eve.
4. Përveç, Komitetit të Menaxhimit të Rrezikut, banka mund të krijojë një organ të veçantë (komitet), i cili është përgjegjës për zbatimin e operacioneve të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit përmes monitorimit dhe kontrollimit ditor të rrezikut të likuiditetit.
5. Sikurse është përcaktuar në paragrafin 4 të këtij Neni, organi i veçantë (komiteti) duhet që së paku të:
  - 5.1. aprovojë dhe monitorojë zbatimin e procedurave të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
  - 5.2. krijojë dhe mbajë sistem efikas për matjen, monitorimin, kontrollimin dhe raportimin e likuiditetit, sipas valutave, të cilat në mënyrë të theksuar ndikojnë në likuiditetin e përgjithshëm të bankës dhe monitorimin e strukturës së aseteve dhe detyrimeve në euro dhe valuta të huaja;
  - 5.3. krijojë ambient për përcjelljen e politikës së menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
  - 5.4. krijojë një sistem adekuat të raportimit tek bordi i Drejtorëve dhe komiteti i menaxhimit të rrezikut për çdo mospajtueshmëri me limitet e ekspozimeve të rrezikut të likuiditetit;
  - 5.5. përcaktojë instrumentet financiare për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit;
  - 5.6. krijojë procedura për përcaktimin dhe monitorimin e stabilitetit të depozitave;
  - 5.7. krijojë procedurë për vlerësimin e efekteve të produkteve të reja në ekspozimin e rrezikut të likuiditetit;
  - 5.8. monitorojë detyrimet e mundshme dhe ekspozimet e bazuara në operacionet jashtëbilancore të bankave.
6. Banka duhet të përfshijë kostot e likuiditetit, përfitimet dhe rreziqet në përcaktimin e çmimeve të brendshme, matjen e performancës dhe procesin e miratimit të produktit të ri për të gjitha aktivitetet e rëndësishme të biznesit (si në zërat në bilancin e gjendjes ashtu dhe në zërat jashtë bilancor), duke përafuar kështu insentivat e ndërmarrjes së rrezikut të linjave individuale të biznesit me ekspozimet ndaj rrezikut të likuiditetit që aktivitetet e tyre krijojnë, për bankën në tërësi.

7. Menaxhmenti i Lartë duhet të përfshijë në mënyrë të duhur kostot e likuiditetit, përfitimet dhe rreziqet në përcaktimin e çmimeve të brendshme, matjen e performancës dhe procesin e miratimit të produktit të ri për të gjitha aktivitetet e rëndësishme të biznesit (si në bilanc të gjendjes ashtu dhe jashtë bilancit të gjendjes).
8. Menaxhmenti i Lartë duhet të sigurojë që procesi i menaxhimit të likuiditetit të bankës përfshinë matjen e kostove të likuiditetit, përfitimet dhe rreziqet e përfshira në të gjitha aktivitetet e rëndësishme të biznesit, përfshirë aktivitetet që përfshijnë krijimin e ekspozimeve kontingjente të cilat nuk mund të kenë menjëherë ndikim të drejtpërdrejtë në bilanc të gjendjes.
9. Kostot, përfitimet dhe rreziqet, e përmendura në këtë nen, duhet t'i atribuohen në mënyrë të qartë veprimtarisë përkatëse, në mënyrë që insentivat e menaxhimit të linjës të jenë në përputhje dhe të forcojnë tolerancën dhe strategjinë e përgjithshme të rrezikut të likuiditetit të bankës, me një ngarkesë likuiditeti të caktuar siç është e përshtatshme për pozicionet, portfoliot ose transaksionet individuale.
10. Caktimi i kostove, përfitimeve dhe rreziqeve të likuiditetit, sipas paragrafit 9 të këtij neni, duhet të përfshijë faktorë që lidhen me periudhat e parashikuara të mbajtjes së aseteve dhe detyrimeve, karakteristikat e tyre të rrezikut të likuiditetit të tregut dhe çdo faktorë tjetër përkatës, përfshirë përfitimet nga qasja në burime relativisht të qëndrueshme të financimit, siç janë disa lloje të depozitave me pakicë.
11. Matja dhe përcaktimi i këtyre rreziqeve duhet të jetë e qartë dhe transparente në nivelin menaxhues të linjës dhe duhet të përfshijë shqyrtimin se si do të ndikohej likuiditeti në kushte të stresit.
12. Korniza analitike duhet të rishikohet në mënyrë të duhur për të pasqyruar ndryshimin e kushteve të biznesit dhe të tregut financiar dhe kështu të mbajë përafrimin e duhur të insentivave. Për më tepër, kostot, përfitimet dhe rreziqet e rrezikut të likuiditetit duhet të adresohen në mënyrë të qartë në procesin e miratimit të produktit të ri.

## **Neni 5**

### **Strategjia dhe politikat**

1. Banka duhet të hartojë strategjinë dhe politikat për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit.
2. Banka duhet të përcaktojë qartë një tolerancë të rrezikut të likuiditetit që është e përshtatshme për strategjinë e aktivitetit të saj dhe rolin e saj në sistemin financiar.
3. Banka duhet të caktojë një tolerancë të rrezikut të likuiditetit që pasqyron objektivat e aktivitetit të saj, drejtimin strategjik dhe apetitin e përgjithshëm të rrezikut.
4. Bordi i Drejtorëve është përfundimisht përgjegjës për rrezikun e likuiditetit të marrë nga banka dhe mënyrën me të cilën ky rrezik menaxhohet dhe duhet të caktojë tolerancën e rrezikut të likuiditetit të bankës.
5. Toleranca e cila duhet të përcaktojë nivelin e rrezikut të likuiditetit që banka është e gatshme për të marrë, duhet të jetë e përshtatshme për strategjinë e aktivitetit të bankës dhe rolin e saj në sistemin financiar dhe duhet të pasqyrojë gjendjen financiare dhe kapacitetin e financimit të bankës.

6. Toleranca duhet të sigurojë që banka menaxhon likuiditetin e saj fuqishëm në kohë normale në mënyrë të tillë që të jetë në gjendje të përballojë një periudhë të zgjatur të stresit.
7. Toleranca ndaj rrezikut duhet të përcaktohet në mënyrë të tillë që të gjitha nivelet e menaxhmentit të kuptojnë qartë kompromisin (ang. trade off) ndërmjet rreziqeve dhe fitimeve.
8. Menaxhmenti i Lartë duhet të zhvillojë strategjinë, politikat dhe praktikën për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit në përputhje me tolerancën e rrezikut si dhe për të siguruar që banka mbanë likuiditet të mjaftueshëm.
9. Menaxhmenti i Lartë duhet vazhdimisht të rishikojë informacionin mbi zhvillimet e likuiditetit të bankës dhe t'i raportojë bordit të Drejtorëve rregullisht.
10. Bordi i Drejtorëve të bankës duhet të rishikojë dhe aprovojë strategjinë, politikat dhe praktikën lidhur me menaxhimin e likuiditetit së paku në baza vjetore dhe të sigurojë që Menaxhmenti i Lartë menaxhon rrezikun e likuiditetit në mënyrë efektive.
11. Strategjia për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit përmban elementet minimale si në vijim:
  - 11.1. objektivat e strategjisë;
  - 11.2. parimet për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit;
  - 11.3. metodologjinë e përgjithshme që banka do të zbatojë për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit në periudhat afatshkurtra dhe afatgjata;
  - 11.4. metodologjinë e përgjithshme dhe vizionin e bankës për të operuar në shumë tregje dhe burime të financimit; dhe
  - 11.5. politikat për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit.
12. Strategjia për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit hartohet si një dokument i veçantë ose si një pjesë e planit strategjik të bankës. Strategjia duhet rishikohet në baza të rregullta, së paku në baza vjetore.
13. Strategjia duhet të përfshijë politikat specifike mbi menaxhimin e likuiditetit, të tilla si: përbërja dhe maturiteti i aseteve dhe detyrimeve; shumëllojshmëria dhe stabiliteti i burimeve të financimit; qasja për menaxhimin e likuiditetit në valuta të ndryshme, përtej kufijve dhe përtej linjave të biznesit dhe filialeve apo degëve të bankës; qasja për menaxhimin e likuiditetit brenda-ditor; dhe supozimet mbi likuiditetin dhe tregtueshmërinë e aseteve.
14. Strategjia duhet të marrë parasysh nevojat e likuiditetit në kushte normale si dhe implikimet në likuiditetin në periudhat stresuese, natyra e të cilave mund të jetë e shkaktuar nga vetë banka ose nga tregu në përgjithësi, ose kombinim i të dyjave.
15. Strategjia mund të përfshijë objektiva të ndryshme sasiore dhe cilësore të nivelit të Lartë.
16. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që Menaxhmenti i Lartë e shndërron strategjinë në udhëzime të qarta dhe standarde të operimit (p.sh. në formë të politikave, kontrolleve ose procedurave).
17. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që Menaxhmenti i Lartë dhe personeli përkatës kanë ekspertizën e duhur dhe banka ka proceset dhe sistemet për matjen, monitorimin dhe kontrollimin e të gjitha burimeve të rrezikut të likuiditetit.
18. Strategjia e likuiditetit duhet të jetë e përshtatshme për natyrën, shkallën dhe kompleksitetin e aktiviteve të bankës. Në formulimin e kësaj strategjie, banka duhet të përfshijë filialet apo degët

e saj, linjat kryesore të biznesit, gjerësinë dhe shumëllojshmërinë e tregjeve, produktet, dhe juridiksionet (vendet) në të cilat operon, si dhe kërkesat rregullative vendore dhe të vendeve të jashtme ku operon.

19. Menaxhmenti i Lartë duhet të përcaktojë strukturën, përgjegjësitë dhe kontrollet për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit dhe për mbikëqyrjen e pozicioneve të likuiditetit të të gjitha degëve dhe filialeve në juridiksionet në të cilat ushtron aktivitet, dhe të përshkruajë këto elemente qartë në politikat e likuiditetit të bankës.
20. Struktura për menaxhimin e likuiditetit (d.m.th., shkalla e centralizimit ose decentralizimit të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit të bankës) duhet të marrë parasysh çdo kufizim ligjor, rregulator ose operacional në transferimin e fondeve.
21. Menaxhmenti i Lartë dhe Bordi i Drejtorëve duhet të kenë njohuri të plotë për raportet e ngushta ndërmjet rrezikut të financimit të likuiditetit dhe rrezikut të likuiditetit të tregut, si dhe si rreziqet tjera, duke përfshirë rrezikun kreditor, të tregut, operacional dhe reputacional ndikojnë në strategjinë e përgjithshme të rrezikut të likuiditetit të bankës.
22. Strategjia e likuiditetit, politikat kryesore për zbatimin e strategjisë dhe struktura e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit duhet të komunikohen në të gjithë bankën nga menaxhmenti i Lartë. Të gjitha njësitë e biznesit të bankës që kryejnë veprimtari që kanë ndikim në likuiditet duhet të jenë plotësisht të vetëdijshme për strategjinë e likuiditetit dhe të operojnë sipas politikave, procedurave, limiteve dhe kontrolleve të miratuara.
23. Personat përgjegjës për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit duhet të mbajnë raporte të ngushta me personat që monitorojnë kushtet e tregut, si dhe me persona të tjerë që kanë qasje në informacione kritike, siç janë menaxherët e rrezikut kreditor. Gjithashtu, rreziku i likuiditetit dhe ndërveprimi i tij i mundshëm me rreziqe të tjera duhet të përfshihen në rreziqet e adresuara nga komitetet e menaxhimit të rrezikut dhe / ose funksionet e pavarura të menaxhimit të rrezikut.
24. Menaxhmenti i Lartë duhet të sigurojë që banka ka kontrollat të brendshme të përshtatshme për të siguruar integritetin e procesit të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.
25. Menaxhmenti i Lartë duhet të sigurojë që personeli i pavarur operacionalisht, i trajnuar si duhet dhe kompetent është përgjegjës për zbatimin e kontrollave të brendshme. Është thelbësore që personeli në funksionet e pavarura të kontrollit të ketë aftësitë dhe autoritetin për të sfiduar informacionin dhe supozimet e modelimit të ofruara nga linjat e biznesit.
26. Menaxhmenti i Lartë duhet të sigurojë që ndryshimet e nevojshme të zbatohen në kohën e duhur kur ndryshimet e rëndësishme ndikojnë në efektivitetin e kontrollave dhe rishikimeve ose ku kërkohen përmirësimet e kontrollave të brendshme.
27. Auditimi i brendshëm duhet të rishikojë rregullisht zbatimin dhe efektivitetin e kornizës së përcaktuar për kontrollimin e rrezikut të likuiditetit.
28. Menaxhmenti i Lartë duhet të monitorojë nga afër trendet aktuale dhe zhvillimet e mundshme të tregut që mund të paraqesin sfida të rëndësishme, të pashembullta dhe komplekse për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit në mënyrë që të mund të bëjnë ndryshime të duhura dhe me kohë në strategjinë e likuiditetit sipas nevojës.

29. Menaxhmenti i Lartë duhet të përcaktojë procedurat specifike dhe miratimet e nevojshme për përjashtimet nga politikat dhe limitet, duke përfshirë procedurat e përshkallëzimit dhe veprimet pasuese që do të ndërmerren për shkeljet e limiteve.
30. Menaxhmenti i Lartë duhet të sigurojë që stres testet, planet rezervë të financimit dhe rezervat e likuiditetit janë efektive dhe të përshtatshme për bankën.
31. Bordi i Drejtorëve duhet të shqyrtojë raportet e rregullta mbi pozicionin e likuiditetit të bankës.
32. Bordi i Drejtorëve duhet të informohet menjëherë për shqetësimet e reja ose që shfaqen për likuiditetin. Këto përfshijnë rritjen e kostove të financimit ose koncentrimet, madhësinë në rritje të hendekut të financimit, shterimi i burimeve alternative të likuiditetit, shkeljet materiale dhe/ose të vazhdueshme të limiteve, një rënie të konsiderueshme në rezervat e aseteve të lira, me likuiditet të Lartë, ose ndryshimet në kushtet e tregut të jashtëm të cilat mund të sinjalizojnë vështirësitë në të ardhmen.
33. Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë që Menaxhmenti i Lartë i ndërmerrë veprimet e duhura korrigjuese për të adresuar shqetësimet.
34. Politikat për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit duhet rishikuar në baza të rregullta, së paku në baza vjetore dhe minimalisht të përmbajnë:
  - 34.1. identifikimin e rrezikut të likuiditetit që rrjedhë nga produktet dhe operacionet e reja;
  - 34.2. matjen e rrezikut të likuiditetit, veçanërisht të:
    - 34.2.1. pozicionit aktual të likuiditetit, duke përfshirë vlerësimin e aseteve likuide dhe kolateraleve;
    - 34.2.2. parashikimin e rrjedhave hyrëse dhe dalëse të parasë;
    - 34.2.3. përputhja në mes të afatit të maturimit të fondeve dhe të burimeve të financimit;
    - 34.2.4. koncentrimin e depozitave dhe burimeve të tjera të financimit sipas maturiteteve, llojit dhe strukturës së klientëve;
    - 34.2.5. përcaktimit të treguesve të likuiditetit dhe përdorimin e tyre në praktikën e monitorimit në bankë;
    - 34.2.6. përdorimin e stres test-it si elementë/pjesë e monitorimit të rrezikut të likuiditetit;
    - 34.2.7. vlerësimin e rregullt të zhvillimit të tregjeve kur plotësohen nevojat për likuiditet.

## **Neni 6**

### **Sistemi i kontrollit të brendshëm**

1. Banka duhet të vendosë procedurat e duhura të kontrollit të brendshëm për të siguruar integrimin e procesit të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit në kuadër të procesit të menaxhimit të rrezikut të përgjithshëm. Kontrolli i brendshëm i menaxhimit të rrezikut të likuiditetit do të jetë pjesë integrale e sistemit të përgjithshëm të kontrollit të brendshëm, të krijuar në nivel të bankës.
2. Për qëllime të kontrollit të brendshëm të ekspozimeve të rrezikut të likuiditetit, banka duhet të krijojë:
  - 2.1. limitet e aprovimit të rrjedhës së parasë mbi shumat e caktuara dhe monitorimin e pajtueshmërisë me limitet e përcaktuara;



- 2.2. raportimin e mospajtueshmërive të mundshme me limitet e referuara në nën paragrafin 2.1. të këtij paragrafi;
  - 2.3. verifikimin e rregullt të të dhënave dhe informatave të përdorura gjatë përcaktimit të likuiditetit të bankës;
  - 2.4. sigurimin e përputhshmërisë me të gjitha ligjet, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore të BQK-së, si dhe rregullat e brendshme të bankës.
3. Banka duhet të monitorojë dhe kontrollojë vazhdimisht ekspozimet ndaj rrezikut të likuiditetit dhe nevojat e financimit të saj si dhe entiteteve ligjore të saj, linjave të biznesit dhe valutave, duke marrë parasysh kufizimet ligjore, rregullatore dhe operacionale për transferimin e likuiditetit.
  4. Pavarësisht nga struktura e saj organizative dhe shkalla e menaxhimit të centralizuar ose të decentralizuar të rrezikut të likuiditetit, banka duhet të monitorojë dhe kontrollojë vazhdimisht rreziqet e likuiditetit në nivel individual si dhe në nivel të filialeve dhe degëve të bankës në një vend të huaj.
  5. Për secilin vend në të cilin banka është aktive, duhet të sigurojë që ka ekspertizën e nevojshme lidhur me tiparet specifike të vendit për regjimin ligjor dhe rregullator që ndikojnë në menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, duke përfshirë rregullimet për trajtimin e bankave të dështuara, sigurimin e depozitave, kornizat operacionale dhe politikat e kolateralit të bankës qendrore. Njohuritë e tilla duhet të pasqyrohen në proceset e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit.
  6. Në rastin e një ngjarje të lokalizuar të stresit sistematik, banka duhet të ketë procese të vendosura për të lejuar shpërndarjen e likuiditetit dhe burimeve të kolateralit për entitetet e prekura, në atë masë sa lejohet transferimi.
  7. Karakteristikat specifike të tregut dhe rreziqet e likuiditetit të pozicioneve në valuta të huaja duhet të merren parasysh, veçanërisht kur nuk ekzistojnë tregje të huaja të zhvilluara plotësisht. Për tregtimin e valutave në tregjet valutore të zhvilluara mirë, mund të merret një qasje më globale për menaxhimin e valutës, duke përfshirë përdorimin e kontratave të kundërkëmbimit (ang. swaps). Sidoqoftë, banka duhet të vlerësojë në mënyrë kritike rrezikun që aftësia për të kundërkëmbyer valutat mund të humbet shpejtë në kushte të stresit.
  8. Supozimet në lidhje me transferimin e fondeve dhe kolateralit duhet të jenë transparente në planet e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit që janë në dispozicion për rishikim mbikëqyrës. Supozimet e bankës duhet të përfshijnë plotësisht kufizimet rregullatore, ligjore, të kontabilitetit, kreditore, tatimore dhe kufizimet e brendshme për lëvizjen efektive të likuiditetit dhe kolateralit. Gjithashtu duhet të përfshijnë rregullimet operacionale të nevojshme për transferimin e fondeve dhe të kolateralit ndërmjet entiteteve dhe kohën e nevojshme për të përfunduar transferime të tilla sipas atyre rregullimeve.

## **Neni 7**

### **Sistemi i menaxhimit të informacionit**

1. Banka duhet të krijoj një sistem të informacionit për të siguruar me kohë dhe në baza të vazhdueshme matjen, monitorimin, kontrollimin dhe raportimin në procesin e vendim marrjes, për të menaxhuar rrezikun e likuiditetit.
2. Sistemi i informacionit kërkohet së paku të:

- 2.1. matë dhe monitoroj likuiditetin e bankës dhe rrezikun e likuiditetit në baza ditore dhe në periudhë të caktuar kohore;
- 2.2. matë dhe monitoron likuiditetin e bankës, sipas valutave të cilat në mënyrë të konsiderueshme ndikojnë në likuiditetin e përgjithshëm të bankës, në bazë individuale dhe të konsoliduar;
- 2.3. monitoron pajtueshmërinë me limitet e vendosura të ekspozimeve të rrezikut të likuiditetit;
- 2.4. sigurojë të dhëna për përcaktimin e treguesve të likuiditetit dhe përgatitjes së formave raportuese për nevojat e organeve të bankës dhe personave të tjerë të përfshirë në procesin e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
- 2.5. analizojë zhvillimet e bazës së depozitave dhe të përcaktoj dhe monitoroj stabilitetin e depozitave
- 2.6. kryej stres teste.

## **Neni 8**

### **Stres testi i likuiditetit**

1. Banka menaxhon likuiditetin jo vetëm në rrethana "normale", por duhet gjithashtu të jetë e përgatitur për të menaxhuar likuiditetin në kushte të stresit.
2. Bankat duhet kryejnë stres test-in në baza të rregullta me qëllim të identifikimit dhe matjes së ekspozimeve të rrezikut të likuiditetit, nën kushte/situata normale të aktivitetit ditor si dhe në paraqitjen e ambientit të stresuar. Për këtë qëllim bankat duhet të analizojnë efektet e rrjedhës së parasë, të aftësisë paguese afatshkurtër dhe afatgjatë, përgatitjen për të reaguar në kushtet/situatat emergjente dhe vlerësojë aftësinë e rritjes së aseteve përmes identifikimit të burimeve të disponueshme të financimit.
3. Shpeshtësia me të cilën banka do të kryejë stres testet duhet të jetë proporcionale me madhësinë e veprimtarisë së bankës, të ekspozimit të rrezikut të likuiditetit të saj, si dhe me rëndësinë relative të bankës brenda sistemit bankar, por jo më pak se katër herë në vit. BQK-ja mund të kërkojë kryerjen e stres testeve në periudha më të shpeshta.
4. Bordi i Drejtorëve të bankës duhet të analizojë rezultatet e stres testit të paktën çdo tre muaj për të:
  - 4.1. përmirësuar strategjinë dhe politikën e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit;
  - 4.2. hartuar dhe përmirësuar kornizën rregullative të nevojshme për zgjidhjen e çështjeve kryesore lidhur me pozicionin e likuiditetit të bankave;
  - 4.3. zhvilluar plane efektive rezervë për të identifikuar dhe kuantifikuar ekspozimin e bankës ndaj situatave stresuese të mundshme të likuiditetit.
5. Stress-test-et e realizuara nga banka përfshijnë përdorimin e skenarëve të veçantë bazuar në faktorë të brendshëm, të skenarëve të bazuar në kushtet e tregut ku banka vepron, si dhe në faktorë makroekonomikë (faktorë të jashtëm).
6. Rezultatet e këtyre stres testeve duhet të diskutohen plotësisht nga menaxhmenti dhe bazuar në këtë diskutim, duhet të përcaktojnë bazën për ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese ose lehtësuese

për të kufizuar ekspozimet e bankës, për të krijuar një rezervë likuiditeti dhe për të përshtatur profilin e saj të likuiditetit me tolerancën ndaj rrezikut.

7. Skenarët për kryerjen e stress test-eve mund të përfshijnë supozimet e mëposhtme:
  - 7.1. tërheqja e depozitave;
  - 7.2. përkeqësimi i mundshëm i aftësisë së huamarrësve për të shlyer detyrimet, që nënkupton përkeqësim të cilësisë së portfolios kreditorë;
  - 7.3. pamundësia e konvertimit me lehtësi dhe pa humbje të konsiderueshme të aseteve në para të gatshme;
  - 7.4. mundësia e shlyerjes së parakohshme të detyrimeve në kushtet e ekzistencës së opsioneve kontraktuale që e mundësojnë këtë shlyerje;
  - 7.5. rreziku i operimit dhe shkalla e ndikimit të tij në rritjen e rrezikut të likuiditetit;
  - 7.6. ndryshimet në kushtet ekonomike në sektorët ndaj të cilëve banka është ekspozuar dhe përkeqësimin e ekonomisë në tërësi;
  - 7.7. përkeqësimi i funksionimit të tregjeve në të cilat banka operon dhe/ose një reduktim të ndjeshëm të besimit në këto tregje;
  - 7.8. goditjet (ang. shock) e normës së interesit dhe të kursit të këmbimit;
  - 7.9. efektin e ndryshimeve të ndjeshme në vlerën e aseteve të bankës dhe/ose aseteve të pranura prej saj si garanci (kolateral);
  - 7.10. kufizimin e pjesshëm apo të plotë të financimit nga burimet kryesore të financimit, duke përfshirë mundësinë e vazhdueshmërisë së financimit nga banka mëmë;
  - 7.11. ndikimi nga zhvillimet negative ekonomike rajonale dhe globale;
  - 7.12. jolikuiditeti i tregut të aseteve dhe humbja e vlerës së aseteve likuide;
  - 7.13. tërheqja e fondeve të financimit me pakicë;
  - 7.14. (jo) disponueshmëria e burimeve të financimit jo me pakicë të siguruara dhe të pasiguruara;
  - 7.15. korrelacioni ndërmjet tregjeve të financimit ose efektivitetit të diversifikimit ndërmjet burimeve të financimit;
  - 7.16. kërkesat për margjinën shtesë dhe kërkesat për kolateral;
  - 7.17. kohëzgjatja apo afatet e financimit;
  - 7.18. kërkesat kontingjente dhe më konkretisht, tërheqjet e mundshme të linjave të zotuar ndaj palëve të treta ose filialeve ose degëve të bankës;
  - 7.19. likuiditeti i absorbuar nga entitetet jashtëbilancore (ang. off-balance sheet vehicles);
  - 7.20. disponueshmëria e linjave rezervë të lejuara ndaj bankës;
  - 7.21. shterimet e likuiditetit që lidhen me produkte / transaksione komplekse;
  - 7.22. ndikimi i nxitjeve të vlerësimit kreditor;
  - 7.23. konvertibiliteti i valutave dhe qasja në tregjet e këmbimit valutor;

- 7.24. aftësia për të transferuar likuiditetin ndërmjet entiteteve, sektorëve dhe kufijve duke marrë parasysh kontrollat dhe kufizimet ligjore, rregullatore, operacionale dhe të zonës kohore;
  - 7.25. qasja në lehtësirat e bankës qendrore;
  - 7.26. aftësia operacionale e bankës për të monetizuar asetet;
  - 7.27. veprimet korrigjuese të bankës dhe disponueshmëria e dokumentacionit të nevojshëm dhe ekspertizës operacionale dhe përvojës për ekzekutimin e tyre, duke marrë parasysh ndikimin e mundshëm të reputacionit gjatë kryerjes së këtyre veprimeve;
  - 7.28. vlerësimet e rritjes së ardhshme të bilancit të gjendjes; dhe
  - 7.29. çdo situatë tjetër të mundshme që vlerësohet si burim i mundshëm i rrezikut.
8. Supozimet e renditura në paragrafin 7 të këtij neni kanë vlerë udhëzuese për bankën, ndërkohë që banka mund të përdorë ato situata që përshtaten më mirë me kompleksitetin, profilin e rrezikut dhe pjesëmarrjen e saj në sistemin bankar.
  9. Banka përcakton metodologjinë për realizimin e stress test-eve, supozimet e përdorura, si dhe veprimet në kundërpërgjigje të rezultateve të gjeneruara, e cila përfshinë:
    - 9.1. zbatimin, analizën e skenarëve të stress test-eve dhe shpeshhtësinë e realizimit të tyre;
    - 9.2. realizimin e stress test-eve për skenarë individualë dhe skenarë të kombinuar, në kushtet e ndodhjes së njëkohshme të disa skenarëve;
    - 9.3. dokumentimin dhe rishikimin në mënyrë periodike të supozimeve të përdorura për kryerjen e stress test-eve;
    - 9.4. formën dhe shpeshhtësinë e raportimit të rezultateve të stress test-eve në strukturat drejtuese;
    - 9.5. veprimet që duhet të ndërmerren nga strukturat drejtuese apo/dhe strukturat e veçanta të ngarkuara për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, mbështetur në rezultatet e stress testeve.

## **Neni 9**

### **Procesi i stres testit**

1. Stres testet duhet t'i mundësojnë bankës të analizojë impaktin e skenarëve të stresit në pozicionin e saj të likuiditetit të entiteteve individuale dhe linjave biznesore të bankës. Pavarësisht nga struktura organizative e bankës dhe shkallës së centralizimit të menaxhimit të likuiditetit, është me rëndësi që banka të kuptojë se ku mund të lindin rreziqet.
2. Banka duhet të vlerësojë nëse testet shtesë janë të nevojshme për filialet dhe degët e saj që janë të ekspozuara nga rreziqet e konsiderueshme të likuiditetit. Testet duhet të përfshijnë implikimin e skenarëve në horizonte të ndryshme kohore, përfshirë edhe ato brenda ditës (ang. intraday).
3. Shkalla dhe frekuenca e testimit duhet të jetë e përshtatshme me madhësinë e bankës dhe ekspozimin e saj ndaj rrezikut të likuiditetit, si dhe me rëndësinë përkatëse të bankës brenda sistemeve financiare në të cilat operon.
4. Banka duhet të ndërtojë kapacitetin e saj për të rritur shpeshhtësinë e testeve në rrethana të veçanta, të tilla si në kushtet e paqëndrueshme të tregut ose nëse kjo kërkohet nga BQK.

5. Përfshirja aktive e Menaxhmentit të Lartë të bankës është jetike për procesin e stres testit. Menaxhmenti i Lartë duhet të kërkojë që të merren parasysh skenarë rigoroz dhe sfidues të stresit, edhe në kohën kur niveli i likuiditetit të bankës është i mjaftueshëm.

## **Neni 10**

### **Skenarët dhe supozimet**

1. Gjatë përpilimit të skenarëve të stres testeve, banka duhet të merr parasysh aktivitetet, dobësitë si dhe natyrën e saj të veprimit, ashtu që skenarët të përfshijnë rreziqet madhore të financimit dhe të likuiditetit të tregut ndaj të cilave ekspozohet banka.
2. Skenarët duhet të përfshijnë rreziqet që lidhen me faktorët si aktivitetet e biznesit të bankës, produktet (përfshirë instrumentet financiare komplekse dhe zërat jashtëbilancorë) si dhe burimet e financimit. Skenarët e përcaktuar duhet t'i mundësojnë bankës të vlerësojë ndikimin e mundshëm negativ që këta faktorë mund të kenë në pozicionin e saj të likuiditetit.
3. Banka duhet me kujdes të konsiderojë përpilimin e skenarëve si dhe llojllojshmërinë e goditjeve (ang. shocks) të përdorura.
4. Banka, në stres testet e saj duhet të përfshijë skenarët stresues për periudhat afatshkurta dhe afatgjata si dhe specifike për bankën dhe po ashtu për tregun në përgjithësi, përfshirë:
  - 4.1. shterimi i njëkohshëm i likuiditetit të tregut në disa tregje që më parë kanë pasur likuiditet të lartë;
  - 4.2. kufizime të mëdha në qasjen e financimit të siguruar apo të pasiguar (ang. secured or unsecured funding);
  - 4.3. kufizimet në konvertimin e valutave; dhe
  - 4.4. çrregullimet e mëdha operationale apo të shlyerjeve që prekin një apo më shumë sisteme të pagesave ose shlyerjeve.
5. Banka duhet të marrë parasysh ndikimin e mundshëm nga skenarët e rënda të stresit, pavarësisht se sa i qëndrueshëm duket të jetë pozicioni aktual i likuiditetit të saj.
6. Banka duhet të marrë në konsideratë veçanërisht lidhjen ndërmjet zvogëlimit të likuiditetit të tregut dhe kufizimeve në financimin e likuiditetit. Banka gjithashtu duhet të marrë në konsideratë njohuritë dhe rezultatet e stres testeve të kryera për lloje të tjera të rrezikut kur teston pozicionin e saj të likuiditetit dhe të marrë parasysh bashkëveprimin e mundshëm me këto lloje të tjera të rreziqeve.
7. Banka duhet të pranojë që ngjarjet e stresit njëkohësisht mund të shkaktojnë nevojën kritike për likuiditet në kohë në valuta të ndryshme dhe sisteme të shumta pagese dhe të shlyerjes.
8. Testet duhet të pasqyrojnë afatet kohore të sakta për ciklet e shlyerjes së aseteve që mund të likuidohen dhe kohën e nevojshme për transferimin e likuiditetit përtej kufijve.
9. Për më tepër, nëse banka mbështetet në rrjedhat dalëse të likuiditetit nga një sistem për të përmbushur detyrimet në një sistem tjetër, ajo duhet të marrë parasysh rrezikun që çrregullimet operationale ose të shlyerjes mund të ndalojnë ose vonojnë rrjedhat e pritshme ndërmjet sistemeve.

10. Banka duhet të marrë parasysh në stres testet e saj reagimin e mundshëm të sjelljes së pjesëmarrësve të tjerë të tregut ndaj ngjarjeve të stresit në treg dhe shkallën në të cilën një reagim i zakonshëm mund të zmadhoj lëvizjet në treg si dhe të përkeqësojë tendosjen e tregut (ang. market strain).
11. Banka gjithashtu duhet të marrë parasysh ndikimin e mundshëm të sjelljes së saj ndaj pjesëmarrësve të tjerë të tregut.
12. Stres testet e bankës duhet të marrin në konsideratë se si sjellja e kundërpalëve (ose korrespondentëve dhe kujdestarëve të tyre) do të ndikonte në kohën e rrjedhës së parave, duke përfshirë atë në bazë brenda-ditore. Në rastet kur banka përdorë një korrespondent ose kujdestar për të kryer shlyerjen, analiza duhet të përfshijë ndikimin e atyre agjentëve që kufizojnë ofrimin e kreditimit brenda-ditor. Banka gjithashtu duhet të kuptojë ndikimin e ngjarjes së stresit në shfrytëzimi e kredive brenda-ditore nga klientët e saj dhe se si këto nevoja ndikojnë në pozicionin e saj të likuiditetit.
13. Përpilimi i skenarëve duhet të jetë subjekt i rishikimit të rregullt për të siguruar që natyra dhe ashpërsia e skenarëve të testuara të mbeten të përshtatshme dhe përkatëse për bankën. Rishikimet duhet të konsiderojnë ndryshimet në kushtet e tregut; ndryshimet në natyrën, madhësinë ose kompleksitetin e modelit të biznesit dhe aktiviteteve të bankës si dhe përvojën aktuale të situatave stresuese.
14. Banka mund të kryejë një analizë të ndjeshmërisë të rezultateve të stres testit ndaj supozimeve kyçe të caktuara në mënyrë që të identifikojë dhe analizojë faktorët që mund të kenë ndikim të rëndësishëm në profilin e saj të likuiditetit. Analiza të tilla të ndjeshmërisë mund të ofrojnë indikacione shtesë të shkallës së ndjeshmërisë së një banke ndaj faktorëve të caktuar.

## **Neni 11**

### **Shfrytëzimi i rezultateve**

1. Menaxhmenti i Lartë duhet t'i rishikojë skenarët dhe supozimet e stres testeve si dhe rezultatet e stres testeve. Përzgjedhja e skenarëve dhe supozimeve të stres testeve nga banka duhet të jetë e dokumentuar mirë dhe e rishikuar së bashku me rezultatet e stres testeve.
2. Rezultatet e stres testeve dhe dobësitë si dhe çdo veprim i ndërmarrë duhet të raportohet dhe të diskutohet me Bordin e Drejtorëve të bankës. Menaxhmenti i Lartë duhet të integrojë rezultatet e procesit të stres testit në procesin e planifikimit strategjik të bankës ( psh. Menaxhmenti i bankës mund të përshtatë strukturën e aseteve-detyrimeve) dhe në praktikën e menaxhimit të rrezikut në baza ditore ( psh. përmes monitorimit të rrjedhave të ndjeshme të parasë apo zvogëlimit të limiteve të koncentrimin). Rezultatet e stres testeve duhet patjetër të merren parasysh gjatë vendosjes së limiteve të brendshme.
3. Menaxhmenti i Lartë duhet të vendosë se si t'i përfshijë rezultatet e stres testeve në planin rezervë të financimit, për vlerësimin dhe planifikimin e situatave të mungesës së mundshme të financimit. Në rastet kur deficitet e projektuara të financimit janë më të mëdha (apo tepricat e projektuara të financimit janë më të vogla) se ato të përcaktuara në tolerancën e rrezikut të likuiditetit të bankës, Menaxhmenti i Lartë duhet të marrë parasysh nëse duhet të rregullojë pozicionin e likuiditetit të bankës apo të zbatojë planin rezervë të bankës në konsultim me Bordin e Drejtorëve.

## **Neni 12**

### **Plani rezervë i financimit**

1. Banka duhet të përpilojë një plan rezervë për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit për situata emergjente. Banka duhet të rishikojë planin rezervë të financimit (PRF) së paku në baza vjetore, me qëllim marrjen në konsideratë të ndryshimeve të mundshme të kushteve të brendshme dhe të jashtme të operacioneve të bankës. Në rastet kur është e nevojshme, BQK rezervon të drejtën të kërkojë nga banka të testojë planin.
2. Plani rezervë i financimit është pjesë e sistemit të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit dhe përmban:
  - 2.1. ndarje të qartë të detyrave, kompetencave, përgjegjësive dhe vendimmarrjes në lidhje me vënien në zbatim të planit;
  - 2.2. treguesit e paralajmërimit të hershëm të përdorur si sinjalizues për zhvillimin e kushteve të jashtëzakonshme si dhe përcaktimin e personave përgjegjës brenda bankës për monitorimin dhe raportimin e këtyre treguesve;
  - 2.3. kushtet në të cilat do të zbatohet plani;
  - 2.4. përcaktimin e veprimtarive që duhet të ndërmerren, identifikimin e burimeve të mundshme të fondeve, nivelin e tyre dhe përparësitë në përdorim, si dhe përcaktimin e intervaleve kohore brenda të cilëve këto veprimtari duhet të ndërmerren;
  - 2.5. komunikimin me depozituesit kryesorë, partnerët e biznesit, klientët e tjerë dhe publikun;
  - 2.6. të dhënat e kontaktit të personave përgjegjës për zbatimin e planit.
3. Në kushte të situatave stresuese ekonomiko-financiare, banka bashkëpunon ngushtë me BQK-në dhe shkëmben informacion të vazhdueshëm me të mbi gjendjen e saj financiare, si dhe mbi veprimet e ndërmarra për rikthimin e saj në parametra të kënaqshëm.
4. Një plan rezervë i financimit (PRF) është përpilimi i politikave, procedurave dhe planeve të veprimit për t'iu përgjigjur çrregullimeve të rënda në aftësinë e një banke për të financuar disa ose të gjitha aktivitetet e saj në kohën e duhur dhe me një kosto të arsyeshme.
5. Plani rezervë i financimit duhet të jetë në përputhje me kompleksitetin, profilin e rrezikut, qëllimin e operacioneve dhe rolin e bankës në sistemet financiare në të cilat banka operon.
6. Plani rezervë i financimit duhet të përfshijë një përshkrim të qartë të një grupi të larmishëm të masave të mundshme të financimit rezervë, të disponueshme lehtësisht dhe të zbatueshme në mënyrë fleksibile, për ruajtjen e likuiditetit dhe për të kompensuar mungesat e rrjedhës së parave në situata të ndryshme të pafavorshme.
7. Plani rezervë i financimit duhet të përcaktojë burimet e mundshme të financimit rezervë në dispozicion dhe sasinë e fondeve që banka vlerëson se mund të nxirret nga këto burime; procedurat e qarta të përshkallëzimit / prioritizimit që detajon kur dhe si secila prej veprimeve mund dhe duhet të aktivizohet; dhe koha e duhur për të shfrytëzuar fondet shtesë nga secili prej burimeve rezervë.
8. Plani rezervë i financimit duhet të sigurojë një kornizë me një shkallë të lartë fleksibiliteti në mënyrë që banka të mund të përgjigjet shpejtë në situata të ndryshme.

9. Dizajni, planet dhe procedurat e Planit rezervë të financimit duhet të integrohen ngushtë me analizën e vazhdueshme të bankës për rrezikun e likuiditetit dhe me rezultatet e skenarëve dhe supozimeve të përdorura në stres teste. Si i tillë, plani duhet të adresojë çështje në një seri të periudhave të ndryshme kohore, përfshirë ato brenda-ditore.

### **Neni 13**

#### **Përpilimi i planit rezervë dhe procedurave , rolet dhe përgjegjësitë**

1. Planet rezervë të financimit duhet të përgatisin bankën për të menaxhuar një sërë skenarësh të stresit të rëndë të likuiditetit që përfshijnë stresin specifik të vetë bankës dhe stresin e përgjithshëm në gjithë tregun, si dhe ndërveprimin e mundshëm midis tyre.
2. Planit duhet të përfshijë një listë të larmishme të mundësive në mënyrë që menaxhmenti të ketë një pasqyrë të masave rezervë potencialisht në dispozicion. Banka gjithashtu duhet të shqyrtojë periudhat kohore për të cilat masat mund të kryhen nën supozime dhe stresse të ndryshme.
3. Planet rezervë të financimit duhet të përmbajnë politika dhe procedura të qarta që do të mundësojnë që menaxhmenti i bankës të marrë vendime në kohë dhe të bazuar në informacion adekuat, të ekzekutojë masat rezervë me shpejtësi dhe aftësi, dhe të komunikojë në mënyrë efektive për të zbatuar planin në mënyrë efikase, duke përfshirë:
  - 3.1. specifikimin e qartë të roleve dhe përgjegjësi, përfshirë autoritetin për të kërkuar Planin rezervë të financimit. Krijimi i një "ekipi krizash" zyrtar mund të lehtësojë koordinimin dhe vendimmarrjen e brendshme gjatë një krize likuiditeti;
  - 3.2. emrat dhe detajet e kontaktit të anëtarëve të ekipit përgjegjës për zbatimin e Planit rezervë të financimit dhe vendndodhjet e anëtarëve të ekipit; dhe
  - 3.3. përcaktimin e alternativave për rolet kryesore.
4. Për të lehtësuar përgjigjen në kohë të nevojshme për të menaxhuar çrregullimet, plani duhet të përcaktojë një proces të qartë të vendim-marrjes se çfarë veprimesh duhet të ndërmerret në çfarë kohe, kush mund t'i marrë ato dhe cilat çështje duhet të përshkallëzohen në nivele më të larta në bankë.
5. Planit duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë procedurat për të ofruar një koordinim dhe komunikim të brendshëm efektiv përmes linjave dhe lokacioneve të ndryshme të biznesit të bankës. Gjithashtu duhet të adresojë kur dhe si të kontaktojë BQK-në dhe palët e jashtme, të tilla si mbikëqyrësit e vendeve ku operon përmes filialës ose degës, bankat qendrore ose operatorët e sistemit të pagesave.

### **Neni 14**

#### **Planet e komunikimit**

1. Në çdo situatë krize, rrjedha e komunikimeve të qarta duhet të ofrojë siguri dhe informacion për pjesëmarrësit e tregut, punonjësit, klientët, kreditorët, aksionarët dhe BQK-në.
2. Banka duhet të hartojnë një plan që do të ofrojë komunikim në kohë, të qartë, të qëndrueshëm dhe të shpeshtë me palët e brendshme, si dhe me BQK-në, në një kohë stresi, për të mbështetur besimin e përgjithshëm në bankë. Planit gjithashtu duhet të adresojë se kur dhe si të komunikohet me



korrespondentët, kujdestarët, kundërpalët dhe klientët, meqenëse veprimet e këtyre palëve mund të ndikojnë ndjeshëm në pozicionin e likuiditetit të bankës dhe mund të ndryshojnë nga burimi themelor i një problemi.

## **Neni 15**

### **Përpilimi i planeve rezervë të financimit**

1. Në rastet kur banka përpilon Planin Rezervë të Financimit, duhet të marrë parasysh elementet si në vijim:
  - 1.1. ndikimi i kushteve të stresuara të tregut në aftësinë e saj për të shitur ose sekjuritizuar asetet;
  - 1.2. lidhja ndërmjet likuiditetit të tregut të asetit dhe likuiditetit të financimit të asetit (p.sh. humbja e konsiderueshme ose e plotë e mundësive tipike të mundshme të financimit të tregut);
  - 1.3. raundi i dytë dhe efektet e reputacionit në lidhje me ekzekutimin e masave të financimit rezervë; dhe
  - 1.4. mundësia për të transferuar likuiditetin ndërmjet entiteteve të grupit, kufijve dhe linjave të biznesit, duke marrë parasysh limitet dhe kufizimet ligjore, rregullatore, operationale dhe të zonës kohore.
2. Elementet në paragrafin 1 të këtij neni duhet të pasqyrojnë përvojat e mëparshme të bankës ose institucioneve të tjera, gjykimin e ekspertëve, praktikën e tregut dhe njohuritë që banka ka fituar përmes kryerjes së stres testeve.
3. Plani Rezervë i Financimit të bankës (si dhe menaxhimi i përditshëm i rrezikut të likuiditetit të bankës) duhet të pasqyrojnë programet e huazimit të BQK-së dhe kërkesat e kolateralit, nëse ekzistojnë të tilla, duke përfshirë lehtësirat që janë pjesë e operationeve normale të menaxhimit të likuiditetit (p.sh. disponueshmëria e kreditimit sezonal).
4. Përfshirja e huadhënies së BQK-së në Planin Rezervë të Financimit duhet të marrë parasysh llojet e lehtësirave të huadhënies, kolateralin e pranueshëm, procedurat operationale për t'iu qasur fondeve të BQK-së dhe çështjet e mundshme të reputacionit të përfshira në qasjen e tyre.
5. Plani Rezervë i Financimit gjithashtu duhet të përfshijë hapa të mundshëm për të përmbushur pagesat kritike mbi baza brenda-ditore. Në situatat kur burimet e likuiditetit brendaditore bëhen të pamjaftueshme, banka duhet të ketë aftësinë të identifikojë pagesat kritike dhe të rendojë ose caktojë pagesat bazuar në përparësinë e tyre.
6. Në rast të çrregullimeve të rënda, është gjithashtu e rëndësishme që banka të ketë aftësinë për të marrë burime shtesë të likuiditetit brenda-ditor, përfshirë duke identifikuar dhe mobilizuar kolateral shtesë.
7. Ashtu sikurse me stres testet, Plani Rezervë i Financimit gjithashtu duhet të parashikojë që nevojat për shlyerjen në kohë mund të paraqiten jo vetëm nga transaksionet e vetë bankës, por edhe nga ato të klientëve të saj, dhe nga ofrimi i shërbimeve të sistemit e pagesave dhe shlyerjeve (p.sh. duke vepruar si një ofrues i likuiditetit rezervë).
8. Plani Rezervë i Financimit duhet të marrë parasysh procedurat e menaxhimit të rrezikut të të gjitha sistemeve përkatëse dhe për këtë arsye të jetë mjaftueshëm i qëndrueshëm për të trajtuar çrregullimet e njëkohshme në shumë sisteme pagese dhe shlyerjeje.

9. Veçanërisht është e rëndësishme që në zhvillimin dhe analizimin e Planeve Rezervë të Financimit dhe skenarëve të stresit, personeli përkatës i bankës duhet të jetë i njoftuar me procedurat operacionale të nevojshme për transferet e likuiditetit dhe kolateralit në institucione dhe sisteme të ndryshme dhe kufizimet që rregullojnë transferet e tilla. Afatet kohore reale për transferet e tilla duhet të përfshihen në modelimin e likuiditetit.

## **Neni 16**

### **Testimi, përditësimi dhe mirëmbajtja**

1. Planet e Financimit Kontingjent duhet të rishikohen dhe testohen rregullisht për të siguruar efektivitetin dhe realizueshmërinë e tyre operacionale. Aspektet kryesore të këtij testimi përfshijnë sigurimin që rolet dhe përgjegjësitë janë të përshtatshme dhe të kuptuara, duke konfirmuar që informacioni i kontaktit është i përditësuar, duke provuar transferimin e parave të gatshme dhe kolateralit dhe rishikimin që ekziston dokumentacioni i nevojshëm ligjor dhe operacional për të ekzekutuar planin me njoftim në afat të shkurtë.
2. Banka duhet të testojë rregullisht supozimet kryesore, të tilla si aftësinë për të shitur ose riblerë disa asete ose të tërheqë në mënyrë periodike linjat e kreditorë.
3. Menaxhmenti i bankës duhet të rishikojë të gjitha aspektet e planit pas çdo ushtrimi dhe të sigurojë që veprimet pasuese të kryhen.
4. Menaxhmenti i Lartë duhet të rishikojë dhe përditësojë Planin Rezervë të Financimit së paku në bazë vjetore për tu miratuar nga bordi, ose më shpesh kur rrethanat e biznesit ose të tregut ndryshojnë.
5. Plani Rezervë i Financimit duhet të jetë në përputhje me planet e vazhdimësisë së biznesit të bankës dhe duhet të jetë operacional në situata kur marrëveshjet e vazhdimësisë së biznesit kërkohen.
6. Banka duhet të sigurojë koordinim efektiv ndërmjet ekipeve që menaxhojnë çështjet që lidhen me krizat e likuiditetit dhe vazhdimësisë së biznesit. Anëtarët e ekipit të krizës për likuiditetit dhe zëvendësit e tyre duhet të kenë qasje të gatshme në Planin Rezervë të Financimit si brenda ashtu dhe jashtë bankës.

## **KAPITULLI III**

### **PARIMET, TREGUESIT DHE MASAT PËR MENAXHIMIN E RREZIKUT TË LIKUIDITETIT**

## **Neni 17**

### **Elementet kryesore për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut të likuiditetit**

1. Banka identifikon, vlerëson dhe menaxhon rrezikun e likuiditetit duke u bazuar në elementët e mëposhtëm:
  - 1.1. parimet e vlerësimit të rrezikut të likuiditetit;
  - 1.2. planifikimin dhe monitorimin e rrjedhave hyrëse dhe dalëse të parasë;

- 1.3. përcaktimin dhe ruajtjen e një strukture të përshtatshme të maturitetit;
  - 1.4. monitorimin e burimeve të financimit dhe koncentrimin të tyre;
  - 1.5. monitorimin e garancive (kolateralit) për qëllime të likuiditetit;
  - 1.6. monitorimin e linjave të financimit;
  - 1.7. treguesit e likuiditetit.
2. Banka duhet të ketë një proces të shëndoshë për identifikimin, matjen, monitorimin dhe kontrollimin e rrezikut të likuiditetit. Ky proces duhet të përfshijë një kornizë të qëndrueshme për projektimin gjithëpërfshirës të rrjedhave të parasë që rrjedhin nga asetet, detyrimet dhe zërat jashtë-bilancorë përgjatë intervaleve të përshtatshme kohore.
  3. Banka duhet të përcaktojë dhe identifikojë rrezikun e likuiditetit ndaj të cilit është ekspozuar për degët dhe filialet e saj në juridiksionet në të cilat operon. Nevojat e likuiditetit të bankës dhe burimet e likuiditetit në dispozicion për të përmbushur ato nevoja varen posaçërisht nga biznesi i bankës dhe llojllojshmëria e produkteve, struktura e bilancit të gjendjes dhe profilet e rrjedhës së parasë në detyrimet bilancore dhe jashtëbilancore të saj.
  4. Banka duhet të vlerësojë secilin pozicion kryesor të zërave bilancorë dhe jashtëbilancorë, përfshirë efektet e opsioneve të përfshira (ang. embedded options) dhe ekspozimet tjera kontingjente që mund të ndikojnë në burimet e bankës për financim dhe shfrytëzim të tyre dhe përcaktojnë se si mund të ndikojnë në rrezikun e likuiditetit.
  5. Banka duhet të marrë parasysh bashkëveprimet ndërmjet ekspozimeve ndaj rrezikut të likuiditetit të financimit dhe rrezikut të likuiditetit të tregut.
  6. Banka duhet të sigurojë që asetet janë vlerësuar me kujdes duke u bazuar në Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe rregulloret e BQK-së.
  7. Banka duhet të përfshijë plotësisht në menaxhimin e rrezikut të saj duke konsideruar që vlerësimet mund të përkeqësohen nën stresin e tregut dhe duhet të marrë këtë parasysh gjatë vlerësimit të fizibilitetit dhe ndikimit të shitjes së aseteve gjatë periudhës së stresuar, në pozicionin e saj të likuiditetit.
  8. Banka duhet të njohë dhe marrë parasysh ndërveprimet e forta ndërmjet rrezikut të likuiditetit dhe rreziqeve tjera ndaj të cilave është e ekspozuar.
  9. Banka duhet të identifikojë ngjarjet që mund të ndikojnë në perceptimet e tregut dhe të publikut në qëndrueshmërinë e saj, veçanërisht në tregjet jo me pakicë.
  10. Banka duhet të jetë në gjendje të masë dhe parashikojë rrjedhat e saj të ardhshme të parasë për asetet, detyrimet, zotimet jashtëbilancore dhe derivativët gjatë intervaleve të ndryshme kohore, në kushte normale si dhe në kushte të skenarëve të stresuara, përfshirë skenarët e ashpra të stresit.
  11. Lidhur me intervalet kohore mbi të cilat për të identifikuar, matur, monitoruar dhe kontrolluar rrezikun e likuiditetit, banka duhet të sigurojë që praktikatat e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit përfshijnë dhe marrin parasysh një sërë faktorësh. Këta faktorë përfshijnë dobësitë ndaj ndryshimeve në nevojat e bankës për likuiditet dhe kapacitetin e financimit në baza ditore; nevojat e përditshme të likuiditetit dhe kapacitetin e financimit për intervale afatshkurtëra dhe afatmesme deri në një (1) vit; nevojat për likuiditet afatgjatë mbi një (1) vit; dhe dobësitë ndaj ngjarjeve,

aktiviteteve dhe strategjive që mund të krijojnë një pengesë të konsiderueshme në kapacitetin e brendshëm të gjenerimit të parasë së gatshme.

12. Banka duhet të identifikojë, matë, monitorojë dhe kontrollojë pozicionet e saj të rrezikut të likuiditetit për:

12.1. rrjedhat e ardhme të parasë nga asetet dhe detyrimet;

12.2. burimet e kërkesës për likuiditet rezervë dhe shkaktarët e lidhur me to, të shoqëruara me pozicione jashtë-bilancore;

12.3. valutat në të cilat banka është aktive; dhe

12.4. aktivitetet korrespondente, të kujdestarisë dhe të shlyerjes.

## **Neni 18**

### **Rrjedhat e ardhshme të parasë të aseteve dhe detyrimeve**

1. Banka duhet të ketë një kornizë të qëndrueshme të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit që ofron parashikime të mundshme, dinamike të rrjedhës së parasë së gatshme që përfshinë supozimet mbi reagimet e mundshme të sjelljes së kundërpalëve kryesorë ndaj ndryshimit të kushteve dhe që kryhen në nivel mjaftueshëm të detajuar.
2. Banka duhet të përpilojë supozime reale në lidhje me nevojat e saj për likuiditet në të ardhmen, si për afatshkurtër ashtu edhe për afatgjatë, që pasqyrojnë kompleksitetin e biznesit, produkteve dhe tregjeve të bankës.
3. Banka duhet të analizojë kualitetin e aseteve që mund të përdoren si kolateral, në mënyrë që të vlerësojë potencialin e tyre për të ofruar financim të siguar në kushte stresuese.
4. Banka duhet të synojë të menaxhojë kohën e rrjedhave hyrëse në raport me burimet e njohura dalëse në mënyrë që të përfitojë një shpërndarje të përshtatshme të maturiteteve për burimet dhe shfrytëzimin e fondeve.
5. Gjatë vlerësimit të rrjedhave të parasë së gatshme që rrjedhin nga detyrimet, banka duhet të vlerësojë “stabilitetin” e burimeve të saj të financimit, që nënkupton, tendencën e tyre për të mos u tërhequr me shpejtësi në situata stresuese.
6. Banka duhet të vlerësojë mundësinë e vazhdimin të linjave të financimit dhe mundësinë që ofruesit e fondeve të sillen në mënyrë të ngjashme në situata stresuese, dhe për këtë arsye të konsiderojë mundësinë që financimi i siguar dhe i pasiguar mund të shterohet në situata stresuese, në veçanti, për ofruesit e fondeve jo me pakicë, të siguar dhe të pasiguar.
7. Për fonde të siguruara që maturojnë brenda natës, banka nuk duhet të supozojë që ky financim do të ripërtërihet në mënyrë automatike.
8. Banka duhet të vlerësojë disponueshmërinë e lehtësirave rezervë të financimit me afat dhe rrethanat në të cilat ato mund të përdoren. Banka gjithashtu duhet të marrë parasysh faktorët që ndikojnë në “stabilitetin” e depozitave me pakicë (ang. retail deposits), si madhësia, ndjeshmëria ndaj normës së interesit, lokacioni i depozitorëve dhe kanaleve të depozitave (psh. direkte, përmes internetit apo përmes brokerëve).

## Neni 19

### **Burimet e kërkesës për likuiditet rezervë dhe ngjarjet aktivizuese të lidhura me pozicionet e zërave jashtëbilancorë**

1. Banka duhet të identifikojë, matë, monitorojë dhe kontrollojë rrjedhat e mundshme të parasë së gatshme të lidhura me zotimet në formë të zërave jashtëbilancorë si dhe detyrimeve tjera kontingjente. Banka duhet të përfshijë një kornizë të qëndrueshme për projektimin e pasojave të mundshme nga zotimet e pa tërhequra, të cilat tërhiqen, duke marrë parasysh natyrën e zotimit dhe aftësinë paguese të kundërpalës, si dhe ekspozimet ndaj sektorëve të biznesit dhe gjeografik, meqenëse kundërpalët e sektorëve të njëjtë mund të ndikohen nga stresi në të njëjtën kohë.
2. Proceset e bankës për identifikimin dhe matjen e rrezikut të financimit rezervë duhet të marrin parasysh natyrën dhe madhësinë e “detyrimeve” potenciale jo-kontraktuale, meqenëse detyrimet e tilla në kushte të stresit mund të krijohen ndaj bankës që financon entitetet e lidhura jashtëbilancore.
3. Banka duhet të implementoj sisteme dhe instrumente për të analizuar në mënyrë efektive ngjarjet aktivizuese të likuiditetit dhe të matë se si këto ndryshime ndaj faktorëve bazë të rrezikut mund të shkaktojnë tërheqjet e kontratave që kanë për bazë zotimet e pa-tërhequra dhe instrumentet jashtëbilancore edhe në rastet kur nuk ekziston evidencë historike të tërheqjeve të tilla. Këto analiza duhet të përfshijnë supozimet e përshtatshme për sjelljet si të bankës ashtu edhe të huamarrësve ose kundër-palëve.
4. Për qëllim të këtij neni, ngjarjet aktivizuese (ang. triggering events) janë ngjarjet të cilat mundësojnë që zotimet të tërhiqen dhe kështu mund të krijojnë nevojën për likuiditet. Për shembull, ngjarjet aktivizuese mund të përfshijnë ndryshimet në variablat apo kushtet ekonomike, përkeqësim të vlerësimit kreditor, problemet e rrezikut të shtetit (ang. country risk) dhe çrregullime specifike të tregut (psh. të letrave komerciale).
5. Banka duhet të menaxhojë rrezikun e likuiditetit për zëra të caktuar jashtëbilancorë që mund të materializohen në periudha të stresit. Këto zëra përfshijnë:
  - 5.1. entitetet me qëllime të veçanta (ang. SPV);
  - 5.2. derivativët financiar; dhe
  - 5.3. garancitë dhe zotimet.
6. Banka duhet të ketë njohuri të hollësishme për ekspozimin kontingjent të rrezikut të likuiditetit dhe aktivizuesit e ngjarjes që rrjedhin nga çdo marrëdhënie kontraktuale apo jo-kontraktuale me entitetet me qëllime të veçanta. Banka duhet të përcaktojë nëse një filialë me qëllime të veçanta apo entitet tjetër me qëllime të veçanta (në çdo rast një entitetet me qëllime të veçanta ang. SPV) i bankës konsiderohet të jetë burim apo shfrytëzim i likuiditetit i bazuar në mundësitë që një burim apo shfrytëzim i tillë të ndodhë nëse banka apo entiteti me qëllime të veçanta përjetojnë rrethana të pafavorshme të likuiditetit, pavarësisht nëse entiteti me qëllime të veçanta është konsoliduar për qëllime të kontabilitetit ose nëse nuk është konsoliduar.
7. Kur banka ofron lehtësira kontraktuale të likuiditetit ndaj një entiteti për qëllime të veçanta (ang.SPV), apo kur përndryshe mund të ketë nevojë për të mbështetur likuiditetin e një entiteti me qëllime të veçanta (ang.SPV) në kushte të pafavorshme, banka duhet të marrë parasysh se si likuiditeti i saj mund të ndikohet negativisht nga mungesa e likuiditetit e entitetit me qëllime të veçanta (ang. SPV-së). Në këto raste, banka duhet të monitorojë rrjedhat hyrëse (të aseteve që

maturojnë) dhe rrjedhat dalëse (të detyrimeve që maturojnë) të entitetit me qëllime të veçanta (ang.SPV-së) si pjesë e planifikimit të saj të likuiditetit, përfshirë stres testin dhe analizën e skenarëve. Në këto kushte, banka duhet të vlerësojë pozicionin e likuiditetit të bankës që përfshijnë tërheqjet e likuiditetit të entitetit me qëllime të veçanta (ang. SPV-së) (por jo tepricën e likuiditetit).

8. Banka duhet të konsiderojë nëse përdorimi i entiteteve me qëllime të veçanta të sekjuritizimit si burim i financimit do të vazhdojë të jetë në dispozicion për bankën edhe në skenarët e pafavorshëm për bankën dhe duhet të pasqyrojë këtë në menaxhimin e likuiditetit të ardhshëm.

## **Neni 20**

### **Derivatvët financiarë**

Banka duhet të përfshijë rrjedhat e parasë lidhur me ricaktimin e çmimit, ushtrimin ose maturimin e kontratave financiare të derivativëve në analizën e rrezikut të saj të likuiditetit, duke përfshirë mundësinë që kundërpalët të kërkojnë kolateral shtesë në një rast të tillë si rënia e vlerësimit kreditor të bankës ose aftësia paguese ose një rënie në çmimin e asetit bazë. Konfirmimi në kohë i transaksioneve të derivativëve jashtë bursave është thelbësor për analiza të tilla, sepse tregtitë e pakonfirmuara vëjnë në pikëpyetje saktësinë e masave të bankës të ekspozimit të mundshëm.

## **Neni 21**

### **Garancitë dhe zotimet**

Banka duhet të vlerësojë që zotimet kreditore të pashfrytëzuara, letrat kreditore dhe garancitë financiare përfaqësojnë potencialisht një shterim të konsiderueshëm të fondeve për bankën. Banka duhet të jetë në gjendje të përcaktojë një nivel "normal" të rrjedhave dalëse të parasë së gatshme në kushte të zakonshme, dhe më pas të vlerësojë hapësirën për një rritje të këtyre rrjedhave gjatë periudhave të stresit.

## **Neni 22**

### **Valutat në të cilat banka është aktive**

1. Banka duhet të vlerësojë nevojat e saj totale për likuiditet në valutë të huaj dhe të përcaktojë mospërputhjet e pranueshme të valutës. Banka duhet të ndërmarrë një analizë të veçantë të strategjisë së saj për secilën valutë në të cilën ka një aktivitet të rëndësishëm, duke marrë parasysh kufizimet e mundshme në kohë stresit.
2. Madhësia e mospërputhjeve e valutës së huaj duhet të marrë parasysh:
  - 2.1. aftësinë e bankës për të mbledhur fonde në tregjet e valutave të huaja;
  - 2.2. mundësia e zgjerimit të lehtësirave rezervë të valutave të huaja të disponueshme në tregun e saj të brendshëm;
  - 2.3. aftësinë për të transferuar një tepricë të likuiditetit nga një valutë në tjetrën dhe nëpër juridiksione dhe entitete ligjore; dhe

- 2.4. mundësinë e konvertimit të valutave në të cilat banka është aktive, përfshirë potencialin për dëmtim ose mbyllje të plotë të tregjeve të kontratave të kundërkëmbimit të valutave të huaja valutore për çifte të veçanta të valutave.
3. Banka duhet të ketë njohuri dhe të ketë aftësinë për të menaxhuar ekspozimet ndaj rrezikut të likuiditetit që rrjedhin nga përdorimi i depozitave në valutë të huaj dhe linjave kreditore afatshkurtëra për të financuar asetet e valutës vendore si dhe financimin e aseteve në valutë të huaj me valutën vendore.
  4. Banka duhet të marrë parasysh rreziqet e ndryshimeve të papritura në kurset e këmbimit të huaj ose likuiditetin e tregut, ose të dyja, të cilat mund të zgjerojnë papritur mospërputhjet e likuiditetit dhe të ndryshojnë efektivitetin e mbrojtjeve të valutave të huaja dhe strategjive mbrojtëse.
  5. Banka duhet të vlerësojë mundësinë e humbjes së hyrjes në tregjet e huaja të këmbimit valutor, si dhe mundësinë e konvertimit të valutave në të cilat banka kryen aktivitetet e saj.
  6. Banka duhet të negociojë një lehtësirë likuiditeti rezervë për një valutë specifike, ose të zhvillojë një strategji rezervë më të gjerë, nëse banka zotëron pozicione të konsiderueshme të rrezikut të likuiditetit në atë valutë.

### **Neni 23**

#### **Aktivitetet korrespondente, kujdestare dhe të shlyerjeve**

1. Banka duhet të kuptojë dhe të ketë aftësinë për të menaxhuar sesi ofrimi i shërbimeve korrespondente, kujdestare dhe shërbimeve bankare të shlyerjes mund të ndikojë në rrjedhat e parave të saj.
2. Banka gjithashtu duhet të kuptojë dhe të ketë aftësinë për të menaxhuar nevojat e mundshme të likuiditetit me të cilat do të përballet si rezultat i dështimit për të përcaktuar procedurat e sistemeve të pagesave dhe shlyerjeve në të cilat ajo është pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë.

### **Neni 24**

#### **Indikatorët matës**

1. Banka duhet të përdorë një grup të instrumenteve ose të indikatorëve matës të personalizuar, të cilat mund të përcaktojnë sasinë e plotë të rrezikut të likuiditetit.
2. Për të marrë një pamje parashikuese të ekspozimeve të rrezikut të likuiditetit, banka duhet të përdorë indikatorë matës që vlerësojnë strukturën e bilancit të gjendjes, si dhe indikatorë matës që projektojnë rrjedhat e parave dhe pozicionet e ardhshme të likuiditetit, duke marrë parasysh rreziqet jashtë-bilancore.
3. Këta indikatorë matës duhet të përfshijnë dobësitë në të gjithë biznesin në kushte të zakonshme si dhe në kushtet stresuese, në intervale të ndryshme kohore. Sipas kushteve të zakonshme të biznesit, masat e mundshme duhet të identifikojnë nevojat që mund të krijohen nga rrjedhat dalëse të parashikuara në lidhje me burimet e zakonshme të financimit. Sipas kushteve të stresit, masat e mundshme duhet të jenë në gjendje të identifikojnë hendeqet e financimit në intervale të ndryshme, dhe nga ana tjetër të shërbejnë si bazë për limitet e rrezikut të likuiditetit dhe treguesit e paralajmërimit të hershëm.

4. Menaxhmenti duhet të përshtatë matjet dhe analizat për rrezikun e likuiditetit në shumëllojshmërinë e veprimtarisë, kompleksitetin dhe profilin e rrezikut të bankës. Matjet dhe analizat duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të përfshijnë rrjedhat e parave dhe implikimet e likuiditetit që rrjedhin nga të gjitha asetet materiale, detyrimet, zërat jashtë-bilancor dhe aktivitetet e tjera të bankës.
5. Analiza duhet të jetë parashikuese dhe të përpiqet të identifikojë mospërputhjet e mundshme të financimit në të ardhmen, në mënyrë që banka të vlerësojë ekspozimin e saj ndaj mospërputhjeve dhe të identifikojë burimet e likuiditetit për të zbutur rreziqet e mundshme. Në rrjedhën normale të matjes, monitorimit dhe analizimit të burimeve dhe përdorimeve të fondeve, banka duhet të parashikojë rrjedhat e parasë me kalimin e kohës sipas një numri të skenarëve alternativë. Këto pasqyra "pro-forma" të rrjedhës së parasë së gatshme janë një instrument vendimtar për menaxhimin adekuat të rrezikut të likuiditetit. Këto parashikime shërbejnë për të zhvilluar analiza të "mospërputhjes së rrjedhës së parasë" ose "hendekut të likuiditetit" që mund të bazohet në supozime të sjelljes së aseteve, detyrimeve dhe zërave jashtë-bilancor në të ardhmen, dhe pastaj të përdoren për të llogaritur tepricën ose mungesën kumulative neto gjatë një afati kohor për vlerësimin e likuiditetit.
6. Matja duhet të kryhet gjatë periudhave shtesë në rritje për të identifikuar rrjedhat e parashikuara dhe kontingjente duke marrë parasysh supozimet bazë të lidhura me ndryshimet e mundshme në rrjedhat e parave të gatshme të aseteve dhe detyrimeve.
7. Duke pasur parasysh rolin vendimtar të supozimeve në parashikimin e rrjedhave të ardhshme të parasë së gatshme, banka duhet të ndërmarrë hapa për të siguruar që supozimet e saj janë të arsyeshme dhe të përshtatshme, të dokumentuara dhe të rishikuara si dhe të aprovuara periodikisht. Supozimet rreth kohëzgjatjes së depozitave pa afat dhe aseteve, detyrimeve dhe zërave jashtëbilancor me rrjedha të parasë së gatshme të pasigurta dhe disponueshmëria e burimeve alternative të fondeve gjatë periudhave të stresit të likuiditetit janë të një rëndësie të veçantë. Supozimet në lidhje me likuiditetin e tregut të pozicioneve të tilla duhet të rregullohen në përputhje me kushtet e tregut ose rrethanat specifike të bankës.

## **Neni 25**

### **Kontrolli i rrezikut të likuiditetit përmes limiteve**

1. Banka duhet të vendosë limite për të kontrolluar ekspozimin ndaj rrezikut të likuiditetit.
2. Banka duhet të rishikojë rregullisht limitet e tilla dhe procedurat përkatëse të përshkallëzimit. Limitet duhet të jenë të rëndësishme për biznesin për sa i përket lokacionit, kompleksitetit të veprimtarisë, natyrës së produkteve, valutave dhe tregjeve në të cilat operon.
3. Limitet duhet të përdoren për menaxhimin e likuiditetit të përditshëm brenda dhe përgjatë linjave të biznesit dhe entiteve ligjore në kushte "normale".
4. Korniza e limiteve gjithashtu duhet të përfshijë masat që synojnë të sigurojnë që banka mund të vazhdojë të operojë në një periudhë stresi të tregut, stresit specifik të bankës dhe një kombinim i të dyjave. Qëllimi i masave të tilla është të sigurojnë që, në kushtet e stresit, likuiditeti i disponueshëm të tejkalojë nevojat e likuiditetit.



## Neni 26

### Treguesit e paralajmërimit të hershëm

1. Banka duhet të hartojë një sërë treguesish për të ndihmuar procesin për të identifikuar shfaqjen e rrezikut ose dobësive në rritje në pozicionin e saj të rrezikut të likuiditetit ose nevojat e mundshme të financimit. Treguesit e tillë të paralajmërimit të hershëm duhet të identifikojnë çdo trend negativ dhe të shkaktojnë një vlerësim dhe reagim të mundshëm nga menaxhmenti në mënyrë që të zbutet ekspozimi i bankës ndaj rrezikut në zhvillim.
2. Treguesit e paralajmërimit të hershëm mund të jenë cilësorë ose sasiorë në natyrë dhe mund të përfshijnë por nuk kufizohen në këto:
  - 2.1. rritje e shpejtë e aseteve, veçanërisht kur financohet me detyrime potencialisht të paqëndrueshme;
  - 2.2. koncentrimet në rritje në asete ose detyrime;
  - 2.3. rritjet e mospërputhjeve të valutave;
  - 2.4. një rënie e maturitetit mesatar të peshuar të detyrimeve;
  - 2.5. incidente të përsëritura të pozicioneve që afrohen ose shkelin limitet e brendshme ose rregullatore;
  - 2.6. trendet negative ose rreziku i rritur i shoqëruar me një linjë të veçantë produkti, siç janë rritja e vonesave në pagesat e ekspozimeve kreditore;
  - 2.7. përkeqësimi i konsiderueshëm i fitimeve të bankës, cilësisë së aseteve dhe gjendjes së përgjithshme financiare;
  - 2.8. publiciteti negativ;
  - 2.9. një ulje e vlerësimit kreditor;
  - 2.10. rënia e çmimit të aksioneve ose rritja e kostove të borxhit;
  - 2.11. rritja e borxhit ose spredit (ang. spread) të kontratës kreditore kundërkëmbimi të dështuar/pashlyer (ang. “Credit Default Swap”);
  - 2.12. rritja e kostove të financimit jo me pakicë (ang. wholesale) ose me pakicë (retail);
  - 2.13. kundërpalët që fillojnë të kërkojnë ose kërkojnë kolateral shtesë për ekspozimet kreditore ose që i rezistojnë hyrjes në transaksione të reja;
  - 2.14. bankat korrespondente që eliminojnë ose ulin linjat e tyre kreditore;
  - 2.15. rritja e rrjedhave dalëse të depozitave me pakicë;
  - 2.16. rritja e riblerjeve të çertifikatave të depozitit para maturimit;
  - 2.17. vështirësi në qasjen e financimit afatgjatë;
  - 2.18. vështirësi në qasjen e detyrimeve afatshkurtra (p.sh. letra komerciale).
3. Banka duhet të ketë treguesit e paralajmërimit të hershëm që sinjalizojnë nëse aktivizuesit e përfshirë (ang. embedded triggers) në produkte të caktuara (p.sh. borxhi publik i kërkueshëm, transaksionet derivative jashtë bursave) janë gati të shkelen (breached) ose nëse rreziqet kontingjente mund të qartësohen (të tilla si linjat rezervë në institucionet financiare jobankare që

emetojnë Letra Komeriale të Mbuluara me Asete (ang. ABCP conduits) gjë që do të bënte që banka të siguronte mbështetje shtesë të likuiditetit për produktin ose të sillte asetë në bilancin e gjendjes.

## **Neni 27**

### **Sistemi i monitorimit**

1. Banka duhet të ketë një Sistem të Menaxhimit të Informacionit të besueshëm, me qëllim për të siguruar bordin e drejtorëve, menaxhmentin e lartë dhe personelin tjetër të duhur me informacion në kohë dhe të parashikueshëm mbi pozicionin e likuiditetit të bankës.
2. Sistemi i menaxhimit të informacionit duhet të ketë aftësinë për të llogaritur pozicionet e likuiditetit në të gjitha valutat në të cilat banka zhvillon aktivitetet e saj përmes filialës ose degës në të gjitha juridiksionet në të cilat banka është aktive. Sistemi i menaxhimit të informacionit duhet të mbulojë të gjitha burimet e rrezikut të likuiditetit, përfshirë rreziqet kontingjente dhe shkaktarët e lidhur me to dhe ato që rrjedhin nga aktivitete të reja, dhe të ketë aftësinë për të dhënë informacione më të detajuara dhe të ndjeshme në kohë gjatë ngjarjeve të stresit. Për të menaxhuar dhe monitoruar në mënyrë efektive kërkesat e saj të financimit neto, banka duhet të ketë aftësinë për të llogaritur pozicionet e likuiditetit në bazë brenda-ditore, në bazë ditore për intervale më të shkurtëra kohore, dhe për një seri periudhash më të gjata.
3. Sistemi i Menaxhimit të Informacionit duhet të përdoret në menaxhimin e përditshëm të rrezikut të likuiditetit për të monitoruar pajtueshmërinë me politikat, procedurat dhe limitet e vendosura të bankës.
4. Për të lehtësuar monitorimin e rrezikut të likuiditetit, Menaxhmenti i Lartë duhet të përcaktojë një sërë kriteresh raportimi, duke specifikuar fushën, mënyrën dhe frekuencën e raportimit për përdorues të ndryshëm (të tillë si bordi i drejtorëve, Menaxhmenti i Lartë, komiteti i asetëve - detyrimeve) dhe palët përgjegjëse për përgatitjen e raporteve. Raportimi i masave të rrezikut duhet të bëhet në baza të shpeshta (p.sh. raportimi ditor për ata që janë përgjegjës për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit, dhe në secilën mbledhje të bordit gjatë periudhave normale, me raportimin që rritet në kohë stresi) dhe duhet të krahasojë ekspozimet aktuale të likuiditetit me limitet e caktuara për të identifikuar çdo presion të shfaqur dhe shkelje të limiteve.
5. Shkeljet në limitet e rrezikut të likuiditetit duhet të raportohen dhe limitet dhe udhëzimet e raportimit duhet të specifikohen për përshkallëzimin në nivele më të larta të menaxhimit, bordit të drejtorëve dhe BQK-së.

## **Neni 28**

### **Strategjia e financimit**

1. Banka duhet të krijojë një strategji të financimit që siguron diversifikim efektiv në burimet dhe kohëzgjatjen e financimit. Banka duhet të ketë prezencë të vazhdueshme në tregjet e përzgjedhura të financimit si dhe të ketë marrëdhënie të qëndrueshme me ofruesit e financimit për të promovuar diversifikimin efektiv të burimeve të financimit.
2. Banka rregullisht duhet të vlerësojë kapacitetin e saj për të mbledhur shpejt fonde nga çdo burim. Banka duhet të identifikojë faktorët kryesorë që ndikojnë në aftësinë e saj për të mbledhur fonde

dhe t'i monitorojë nga afër këta faktorë për t'u siguruar që vlerësimet e kapacitetit për mbledhjen e fondeve të mbesin të vlefshme.

3. Banka duhet të diversifikojë burimet e financimit në dispozicion në periudhën afatshkurtë, afatmesme dhe afatgjatë. Objektivat e diversifikimit duhet të jenë pjesë e planeve të financimit për periudhat afatmesme deri afatgjatë dhe duhet të jenë në përputhje me procesin e planifikimit buxhetor dhe biznesor.
4. Planet e financimit duhet të marrin parasysh korrelacionin ndërmjet burimeve të financimit dhe kushteve të tregut. Diversifikimi i pritur gjithashtu duhet të përfshijë limitet sipas kundërpalëve, financim i tregut të siguruar ndaj financimit të pasiguar, llojit të instrumentit, entitetit të sekjuritizimit, valutës, dhe lokacionit të tregut.
5. Si praktikë e përgjithshme e menaxhimit të likuiditetit, bankat duhet të kufizojnë koncentrimin në ndonjë burim të veçantë të financimit apo kohëzgjatjes.
6. Bankat duhet të sigurojnë që financimi jo me pakicë (ang. wholesale funding) të jetë mjaftueshëm i diversifikuar për të mbajtur disponueshmërinë në kohë të fondeve në maturitetet e duhura dhe me kosto të arsyeshme.
7. Banka duhet të kenë qasje në burime të diversifikuara të likuiditetit për secilën valutë në rastet kur është aktive në valuta të ndryshme.
8. Menaxhmenti i Lartë duhet të jetë i informuar për përbërjen, karakteristikat dhe diversifikimin e aseteve dhe burimeve të financimit të bankës. Menaxhmenti i Lartë gjithashtu duhet të rishikojë rregullisht strategjinë e financimit në rast të çdo ndryshimi në ambientet e brendshme apo të jashtme.

## **Neni 29**

### **Menaxhimi i qasjes në treg**

1. Menaxhmenti i lartë duhet të sigurojë që qasja në treg menaxhohet, monitorohet dhe testohet në mënyrë aktive nga stafi i duhur.
2. Banka duhet të ketë prezencë aktive brenda tregjeve që lidhen me strategjinë e saj të financimit. Kjo kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe investim të duhur dhe të përshtatshëm në infrastrukturë, procese dhe mbledhje të informacionit.
3. Banka nuk duhet të supozojë që mund të ketë qasje në tregje në kohën e duhur për të cilët nuk ka krijuar sistemet ose dokumentacionin e nevojshëm, ose kur këto rregullime nuk janë përdorur në mënyrë periodike ose banka nuk ka konfirmuar që kundërpalët e gatshme ekzistojnë. Përfshirja e klauzolave të shitjes së huasë në dokumentacionin e huasë dhe përdorimi i rregullt i disa tregjeve të shitjes së aseteve mund të ndihmojë në rritjen e aftësisë së një banke për të ekzekutuar shitje të aseteve me kundërpalë të ndryshme në kohë stresi. Në të gjitha rastet, banka duhet të ketë njohuri të plota të kornizës ligjore që rregullon shitjet e mundshme të aseteve dhe të sigurojë që dokumentacioni të jetë i besueshëm dhe ligjërish i qëndrueshëm.
4. Banka duhet të identifikojë dhe ndërtojë marrëdhënie të forta me investitorët aktualë dhe potencialë, madje edhe në tregjet e financimit të lehtësuara nga ndërmjetësuesit ose palët tjera të treta. Banka duhet të marrë një vështrim të kujdesshëm se si këto marrëdhënie do të tensionohen në kohë stresi.

5. Skenarët e stres testit dhe planet rezervë të financimit duhet të marrin në konsideratë ndikimet që humbjet dhe zvogëlimi i kapitalit i rezultuar mund të kenë në aftësinë e bankës për të mbajtur marrëdhëniet e financimit.
6. Banka duhet të identifikojë burime alternative të financimit që forcojnë kapacitetin e saj për t'i përballuar një shumëllojshmërie goditjesh të forta të likuiditetit por të besueshme për bankën dhe tregun në përgjithësi.
7. Në varësi të natyrës, ashpërsisë dhe kohëzgjatjes së goditjes së likuiditetit, burimet e mundshme të financimit përfshijnë sa vijon:
  - 7.1. rritjen e depozitave;
  - 7.2. zgjatjen e afateve të detyrimeve;
  - 7.3. emetimet e reja të instrumenteve të borxhit afatshkurtra dhe afatgjata;
  - 7.4. transferimet e fondeve brenda grupit, emetimet e reja të kapitalit, shitja e filialeve ose linjave të biznesit;
  - 7.5. sekjuritizimin e aseteve;
  - 7.6. shitjen ose riblerjen e aseteve të lira (pa ngarkesë), mjaftë likuide;
  - 7.7. tërheqjen e lehtësirave të zotuar;
  - 7.8. huazimin nga lehtësitë marxhinale të huasë të bankës qendrore.
8. Menaxhmenti i bankës duhet të rishikojë dhe testojë rregullisht opsionet e saj të mbledhjes së fondeve për të vlerësuar efektivitetin e tyre në sigurimin e likuiditetit në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.
9. Banka duhet të menaxhojë në mënyrë aktive pozicionet brenda ditore dhe rreziqet e saj të likuiditetit për të përmbushur detyrimet e pagesave dhe shlyerjeve me kohë në kushte normale dhe stresuese dhe kështu të kontribuojë në funksionimin e duhur të sistemeve të pagesave dhe shlyerjeve.
10. Banka duhet të miratojë objektivat e menaxhimit të likuiditetit brenda ditore që i lejojnë:
  - 10.1. të identifikojë dhe t'i japë prioritet detyrimeve specifike kohore dhe të tjera kritike për t'i përmbushur ato kur pritet, dhe
  - 10.2. të shlyejë detyrimet tjera më pak kritike sa më shpejtë të jetë e mundur.
11. Strategjia e bankës për të arritur objektivat e saj të menaxhimit të likuiditetit brenda ditore duhet të përfshijë të paktën gjashtë elemente operative si në vijim:
  - 11.1. banka duhet të ketë aftësinë për të matur bruto rrjedhat hyrëse dhe dalëse të likuiditetit të pritshëm ditore, të parashikojë kohën brendaditore të këtyre rrjedhave kur është e mundur, dhe të parashikojë intervalin e mungesave të mundshme të financimit neto që mund të krijohet në pika të ndryshme gjatë ditës;
  - 11.2. Banka duhet të ketë aftësinë për të monitoruar pozicionet e likuiditetit brendaditor kundrejt aktiviteteve të pritura dhe burimeve të disponueshme (bilancet, kapaciteti i kreditor brendaditor në dispozicion, kolaterali në dispozicion);

- 11.3. Banka duhet të rregullojë marrjen e fondeve të mjaftueshme brendaditore për të përmbushur objektivat e saj brendaditore;
- 11.4. Banka duhet të ketë aftësinë për të menaxhuar dhe mobilizuar kolateralin siç është e nevojshme për të marrë fonde brenda ditës. Banka duhet të ketë në dispozicion kolateral të mjaftueshëm për të fituar nivelin e likuiditetit brendaditor që nevojitet për të përmbushur objektivat e saj brenda ditës. Banka duhet të ketë rregullime operacionale për të lënë peng ose për dorëzuar kolateralin në bankat qendrore, korrespondentët, kujdestarët dhe kundërpalët. Banka, gjithashtu duhet të kuptojë afatet kohore të kërkuara për të mobilizuar forma të ndryshme të kolateralit, përfshirë kolateralin e mbajtur në baza ndërkufitare;
- 11.5. Banka duhet të ketë aftësi të qëndrueshme për të menaxhuar kohën e rrjedhave dalëse të likuiditetit në përputhje me objektivat e saj brendaditore;
- 11.6. Banka duhet të jetë e përgatitur për t'u marrë me çrregullimet e papritura të rrjedhave të saj të likuiditetit brendaditore. Banka gjithashtu duhet të kuptojë nivelin dhe kohën e nevojave të likuiditetit që mund të krijohen si rezultat i mos-shlyerjes së procedurave të sistemeve të pagesave dhe shlyerjeve në të cilat ajo është pjesëmarrëse e drejtpërdrejtë. Menaxhimi i qëndrueshëm i rrezikut operacional dhe rregullimet e vazhdimësisë së biznesit janë gjithashtu kritike për efektivitetin e menaxhimit të likuiditetit brendaditor të bankës.
12. Banka duhet të ketë politika, procedura dhe sisteme për të mbështetur këto objektiva operacionale në të gjitha valutat dhe tregjet financiare në të cilat ka rrjedha të konsiderueshme të pagesave dhe shlyerjeve. Asetet dhe burimet e aplikuar duhet t'i përshtaten modelit dhe rolit të biznesit të bankës në sistemin financiar, si dhe mënyrën se si banka i zhvillon aktivitetet e saj në një treg të veçantë (psh. përmes participimit direkt në sistemin e pagesave dhe të shlyerjeve apo përmes bankës kujdestare apo korrespondente) dhe nëse ajo ofron shërbime si bankë korrespondente apo kujdestare dhe lehtësira kreditore (ang. credit facilities) brenda ditës për bankat, shoqëritë ose sistemet.
13. Banka duhet të njohë potencialin për ndërprerjet operacionale apo financiare, te korrespondenti apo kujdestari i saj, për të çrregulluar menaxhimin e likuiditetit të bankës si dhe duhet të ketë rregullime alternative për të siguruar që mund të vazhdojë me përmbushjen e detyrimeve të saj në situata të tilla.
14. Banka duhet të menaxhojë në mënyrë aktive pozicionet e saj të kolateralit, duke bërë dallime në mes të aseteve të ngarkuara dhe atyre që janë të lira.
15. Banka duhet të monitorojë entitetin ligjor dhe lokacionin ku mbahet kolaterali dhe se si mund të shfrytëzohet në kohën e duhur.
16. Banka duhet të ketë aftësinë për të llogaritur të gjitha pozicionet e saj të kolateralit, përfshirë asetet që janë lënë peng aktualisht në krahasim me vlerën e garancisë që kërkohet dhe aseteve të lira në dispozicion për t'u lënë peng. Niveli i kolateralit të bankës në dispozicion duhet të monitorohet sipas entitetit ligjor, sipas juridiksionit dhe sipas ekspozimit valutor, si dhe sistemet duhet të jenë në gjendje për të monitoruar lëvizjet në mes të përdorimit të kolateralit brenda ditës dhe brenda natës ose përdorimit të kolateralit sipas afatit.
17. Banka duhet të kujdeset për kërkesat operacionale dhe kohore të lidhura me qasjen në kolateral, marrë parasysh lokacionin e kolateralit (psh. te banka kujdestare apo te sistemi i shlyerjes së letrave me vlerë në të cilin mbahet kolaterali).

18. Banka duhet të vlerësojë pranueshmërinë e secilës klasë të aseteve kryesore për të lënë peng si kolateral te bankat qendrore si dhe pranueshmërinë e aseteve për kundërpalët kryesore dhe ofruesit e financimit në tregjet e siguruara të financimit. Banka duhet të diversifikojë burimet e saj të kolateralit, duke marrë parasysh kufizimet e kapacitetit, koncentrimet specifike të emrit, ndjeshmërinë e çmimeve, zvogëlimin e vlerës (ang. haircut) dhe kërkesat e kolateralit në kushtet e stresit specifik të emrit dhe të tregut në përgjithësi, dhe disponueshmërinë e fondeve nga kundërpalët nga sektori privat në skenarë të ndryshëm të stresimit të tregut.
19. Banka duhet të rregullojë, sipas nevojës, matjet e kolateralit në dispozicion për të llogaritur asetet që janë pjesë e “pozicionit të lidhur (ang. tied position)” ( psh. asetet e përdorura si pjesë e një mbrojtjeje të zërave jashtëbilancor apo pozicionit derivativ, të tilla si pozicioni kapital/detyrim si mbrojtje ndaj një kontrate kundërkëmbimi për shlyerje gjithsej (ang. Total Return Swap) apo tregtimi me bazë negative (ang. negative basis trade).
20. Banka duhet të ketë njohuri të detajuar dhe të jetë në gjendje të dëshmojë, periudhën e parashikuar kohore për të likuiduar këto asete ose për të vendosur një mbrojtje zëvendësuese.
21. Banka duhet të ketë kolateral të mjaftueshëm për të përmbushur nevojat e pritura dhe të papritura të huazimit si dhe rritjen e mundshme të kërkesave të margjinës për afate të ndryshme kohore, varësisht nga profili i financimit të bankës.
22. Për të përcaktuar nivelin e kolateralit për t’u lënë peng apo për t’u dorëzuar, banka duhet të marrë parasysh potencialin për pasiguri të konsiderueshme rreth kohës së rrjedhave brenda ditore. Banka gjithashtu duhet të marrë parasysh potencialin për pengesa operationale dhe të likuiditetit që mund të kërkojnë lënien peng apo dorëzimin e kolateralit shtesë brenda ditor.
23. Banka, për rastet që përdorë derivativët, duhet të marrë parasysh potencialin për kërkesën për kolateral shtesë të specifikuar në bazë kontraktuale si rezultat i ndryshimeve në pozicionet në treg apo ndryshimit të vlerësimit kreditor të bankës ose pozitës së saj financiare.
24. Banka duhet gjithashtu të konsiderojë ngjarjet tjera aktivizuese.
25. Sistemi i informimit të bankës duhet të jetë në gjendje të raportojë nëse banka posedon mjaftueshëm asete të lira të llojit dhe cilësisë së duhur për një situatë të tillë.

### **Neni 30**

#### **Parimet e menaxhimit të rrezikut të likuiditetit**

1. Banka identifikon, vlerëson dhe menaxhon rrezikun e likuiditetit duke u bazuar minimalisht në parimet e mëposhtme:
  - 1.1. parimin e mbështetjes në burime të qëndrueshme të financimit;
  - 1.2. parimin e minimizimit të hendekut të maturitetit kontraktual dhe hendekut të maturitetit sipas lëvizjeve reale;
  - 1.3. parimin e diversifikimit të burimeve të financimit sipas llojit, monedhës, instrumenteve, maturimit, numrit të klientëve dhe tregjeve, duke konsideruar nivelin e likuiditetit të tyre;
  - 1.4. parimin e zgjerimit të ekuilibruar/të kontrolluar të veprimtarisë dhe të ruajtjes së një vlere të mjaftueshme të aseteve likuide;

1.5. parimet e disponueshmërisë së burimeve njerëzore për menaxhimin efektiv të rrezikut të likuiditetit.

### **Neni 31**

#### **Planifikimi dhe monitorimi i rrjedhave hyrëse dhe dalëse të parasë**

1. Banka parashikon dhe monitoron rrjedhën hyrëse dhe dalëse të fondeve për periudha të caktuara kohore, i cili duhet të jetë parashikim për një periudhë 1 (një) vjeçare. Ky parashikim konsideron të gjitha llojet e rrjedhave hyrëse dhe dalëse të parasë, duke përfshirë dhe rrjedhat hyrëse dhe dalëse të parasë nga zërat jashtëbilancorë. Banka duhet krahasuar këtë parashikim në intervale të rregullta, me vlerat aktuale të rrjedhave hyrëse dhe dalëse të parasë.
2. Parashikimet për rrjedhat hyrëse të parasë përfshijnë së paku:
  - 2.1. shlyerjet aktuale të kredive (ku niveli i shlyerjeve nuk mund të jetë më i lartë se rrjedhat hyrëse të kontraktuara të parasë, si dhe duke zbritur fondet rezervë të krijuara për humbjet e mundshme);
  - 2.2. konvertimin aktual në paranë e gatshme (ang. cash) të aseteve të cilat nuk kanë afat maturimi të përcaktuar;
  - 2.3. vlerat në para të gatshme (ang. cash) të gjeneruara nga letrat me vlerë investuese;
  - 2.4. mundësitë aktuale të shitjes së aseteve (ku investimet e kapitalit, kreditë me probleme dhe asetet fikse të prekshme trajtohen si asete më pak likuide, duke përjashtuar rrjedhat hyrëse të parasë nga ekzekutimi/et e kolateralit/ëve);
  - 2.5. rritjen e pritshme të depozitave;
  - 2.6. aftësinë e bankës për të siguruar fonde nga burime të tjera dhe disponueshmërinë e burimeve të tregut për financim;
  - 2.7. rrjedhat tjera hyrëse të parasë, bazuar në analizën e të dhënave historike mbi nivelet dhe ecurinë e rrjedhave hyrëse të parasë në periudhat e mëparshme, duke pasur parasysh veçoritë e operacioneve të bankës, ndikimin sezonal, ndjeshmërinë e normës së interesit dhe faktorët makroekonomikë.
3. Parashikimet për rrjedhat dalëse të parasë përfshijnë së paku:
  - 3.1. detyrimet që maturojnë;
  - 3.2. rritjen e ardhshme të nivelit të kredidhënies së bankës;
  - 3.3. nivelet e depozitave dhe detyrimeve të tjera të qëndrueshme bazuar në luhatshmërinë e zakonshme të tyre dhe njohjen e sjelljes dhe interesave të depozituesve;
  - 3.4. depozitat me afat që mund të tërhiqen para afatit të maturimit dhe depozitat pa afat;
  - 3.5. ndikimin e ndryshimit të normës së interesit në nivelin e depozitave;
  - 3.6. nivelin e koncentrimit të depozitave;
  - 3.7. rrjedhat dalëse të parasë nga zërat jashtëbilancorë;

3.8. rrjedhat tjera dalëse të parasë bazuar në analizën historike të të dhënave mbi nivelin dhe ecurinë e rrjedhave dalëse të parasë në periudhat e mëparshme, duke pasur parasysh ndikimin sezonal, ndjeshmërinë e normës së interesit dhe faktorët makroekonomikë.

## **Neni 32**

### **Përcaktimi dhe ruajtja e një strukture të përshtatshme maturiteti**

1. Bankat duhet të monitorojë në baza mujore strukturën e maturitetit të aseteve dhe detyrimeve me qëllim të identifikimit të hendeqeve të mundshme të maturitetit.
2. Banka, për qëllime të matjes dhe monitorimit të hendeqeve, klasifikon rrjedhat hyrëse dhe dalëse të parasë nga asetet (të drejtat), detyrimet (kërkesat) dhe zërat jashtë bilancor, sipas intervaleve të maturimit.
3. Banka përdor si datë të arkëtimit të aseteve datën më të fundit të mundshme të arkëtimit, dhe si datë të shlyerjes së detyrimeve datën më të parë të mundshme të shlyerjes sipas intervaleve të mëposhtme:
  - 3.1. deri në 7 ditë,
  - 3.2. 7 ditë deri në 1 muaj,
  - 3.3. 1 muaj deri në 3 muaj,
  - 3.4. 3 muaj deri në 6 muaj,
  - 3.5. 6 muaj deri në 12 muaj.
4. Banka kryen në mënyrë të vazhdueshme monitorimin e hendeqeve sipas maturitetit të mbetur të pritshëm, duke përdorur për këtë qëllim parashikime rreth rrjedhave të pritshme hyrëse dhe dalëse të parasë, si për shembull ndër të tjera probabilitetin e mbledhjes së aseteve në momentin kur ato maturojnë, probabilitetin e tërheqjes së depozitave përpara maturimit.
5. Banka, në kuadrin e parashikimit të rrjedhave të ardhshme të parasë, sigurohet që supozimet e aprovuara të jenë të arsyeshme, të përshtatshme, të dokumentuara dhe të rishikuara në mënyrë periodike.
6. Banka në përcaktimin e maturitetit të mbetur të aseteve dhe detyrimeve, duhet:
  - 6.1. të ketë një bazë të të dhënave të rrjedhave hyrëse dhe dalëse të parasë mbi të cilat janë mbështetur supozimet;
  - 6.2. të rishikojë në baza të rregullta supozimet e përdorura me qëllim pasqyrimin në këto të fundit të ndryshimeve të mundshme në kushtet e brendshme dhe të jashtme; si dhe
  - 6.3. të sigurojë që supozimet të marrin në konsideratë karakterin sezonal dhe ciklik të rrjedhave hyrëse dhe dalëse të parasë.
7. Banka, sipas metodologjisë së miratuar, mund të klasifikojë (grupojë) rrjedhat e parasë sipas llojit të klientit, maturitetit, monedhës, sektorit, etj.
8. BQK-ja mund të kërkojë aplikimin e supozimeve të ndryshme apo të faktorëve korigjues në parashikimin dhe monitorimin e rrjedhave të parasë sipas maturitetit të pritshëm, në rast se gjykon se këto veprime mundësojnë një pasqyrim më të mirë të profilit të rrezikut të bankës.



9. Banka kryen analizën e hendeqeve të likuiditetit duke u mbështetur kryesisht në kriteret e mëposhtme:
  - 9.1. klasifikimin e aseteve, detyrimeve dhe zërave jashtëbilancorë sipas maturitetit;
  - 9.2. vlerësimin e qëndrueshmërisë së depozitave bazuar në të dhënat historike dhe rezultatet e stress test-eve;
  - 9.3. vendosjen e limiteve për hendeqet e likuiditetit;
  - 9.4. përlllogaritjen e hendeqeve në baza mujore dhe sipas valutave me ndikim të theksuar në likuiditetin e bankës;
  - 9.5. parashikimin e hendeqeve të likuiditetit në të ardhmen;
  - 9.6. çdo kriter tjetër që vlerësohet si i arsyeshëm

### **Neni 33**

#### **Monitorimi i burimeve të financimit dhe koncentrimin të tyre**

1. Banka monitoron në mënyrë periodike burimet e financimit me qëllim ruajtjen e një baze të diversifikuar të këtyre burimeve si dhe identifikimin e koncentrimin të mundshme. Koncentrimet analizohen sipas burimit të financimit, llojit të financimit, tregut, koncentrimin gjeografik, monedhës dhe sipas maturitetit.
2. Monitorimi i burimeve të financimit dhe përqendrimit të tyre përfshinë:
  - 2.1. ruajtjen e marrëdhënieve të qëndrueshme me depozitorët e mëdhenj, bankat korrespondente, klientët e tjerë të rëndësishëm, si dhe me partnerët e biznesit;
  - 2.2. përcaktimin e qëndrueshmërisë së depozitave, duke marrë në konsideratë karakteristikat e depozituesve dhe llojin e depozitës;
  - 2.3. monitorimin e nivelit të diversifikimit të burimeve të financimit;
  - 2.4. përcaktimin dhe monitorimin e lëvizjeve në burimet e tjera të financimit.
3. Banka përcakton dhe monitoron nivelin e koncentrimin të llogarive rrjedhëse dhe depozitave pa afat në monedhën Euro dhe në monedhë të huaj.

### **Neni 34**

#### **Monitorimi i kolateralit për qëllime të likuiditetit**

1. Banka monitoron madhësinë/vlerën e kolateralit të saj, me qëllim të bërjes së dallimit në mes të aseteve të vendosura si kolateral dhe aseteve të lira.
2. Monitorimi efektiv i kolateralit synon përmbushjen e një tërësie kërkesash për kolateral lidhur me sigurimin e likuiditetit afatgjatë, afatshkurtër apo ditor.
3. Banka duhet të zotërojë madhësi të mjaftueshme të kolateralit me qëllim përmbushjen e nevojave të pritshme apo të paparashikuara për huamarrje në tregun financiar, në tregun ndërbankar dhe nga BQK-ja, mbështetur mbi profilin e saj të financimit.

## **Neni 35**

### **Monitorimi i linjave të financimit**

1. Banka vlerëson mundësinë e ri-negocimit të mundshëm të linjave të financimit dhe mundësinë që siguruesit e fondeve të reagojnë në mënyrë të njëjtë edhe në rrethana/kushte jo të zakonshme.
2. Banka merr në konsiderate probabilitetin e shterimit të mundësive për linja financimi në rrethana jo të zakonshme.
3. Banka nuk mund të supozojë ri-negocimin automatik të sigurt në masën 100 % (njëqind për qind) të linjave me afat maturimi njëditor.

## **Neni 36**

### **Rezervë likuiditeti (Asete me cilësi të lartë të likuiditetit)**

1. Banka duhet të mbajë një rezervë të aseteve likuide të lira, me cilësi të lartë, që duhet të mbahen si siguri kundrejt një sërë skenarësh stresues të likuiditetit, duke përfshirë ato që përfshijnë humbjen ose zhvlerësimin e burimeve të siguruara të financimit zakonisht të disponueshme. Nuk duhet të ketë pengesa ligjore, rregullatore ose operacionale për përdorimin e këtyre aseteve për të marrë fonde.
2. Madhësia e rezervës së likuiditetit duhet të jetë në përputhje me tolerancën e vendosur të rrezikut të bankës. Elementet kryesore përfshijnë supozimet në lidhje me madhësinë e mospërputhjeve të rrjedhës së parasë së gatshme, kohëzgjatjen dhe ashpërsinë e stresit dhe vlerën e likuidimit ose huazimit të aseteve (d.m.th. paranë e gatshme të parashikuar në dispozicion të bankës nëse asetet likuidohen ose përdoren si kolateral për financim të siguar) në situata stresuese.
3. Banka duhet të sigurojë që rezerva e aseteve likuide të saj të jetë e madhësisë për të ruajtur qëndrueshmërinë e mjaftueshme ndaj stresit të papritur, ndërsa vazhdon të përmbushë detyrimet e saj ditore të pagesës dhe shlyerjes në një kohë të duhur për kohëzgjatjen e stresit. Banka gjithashtu duhet të marrë parasysh instrumentet dhe burimet e tjera që ka në dispozicion për të menaxhuar rreziqet brenda ditës.
4. Banka duhet të mbajë një bazë të aseteve likuide më të besueshme sa i përket përbërjes së rezervës së saj të likuiditetit, për tu mbrojtur kundrejt skenarëve stresues më të ashpër.
5. Për të siguar kundër ngjarjeve më pak intensive, por me kohëzgjatje më të gjatë të ngjarjeve të stresit, banka mund të zgjedhë të zgjerojë përbërjen e rezervës për të mbajtur asete tjera likuide të lira që janë të tregtueshme (d.m.th., mund të shiten ose përdoren si kolateral në marrëveshjet e shitjes dhe riblerjes) pa rezultuar në humbje ose zbritje të tepruara.
6. Tregtueshmëria e aseteve individuale mund të ndryshojë varësisht nga skenari i stresit dhe kornizës kohore të përfshirë. Sidoqoftë, ekzistojnë disa karakteristika të përgjithshme që synojnë të rrisin likuiditetin e një asemi të caktuar duke përfshirë: transparencën e strukturës së tij dhe karakteristikat e rrezikut; lehtësia dhe siguria e vlerësimit; pranueshmëria e bankës qendrore; thellësia e tregut për asetin, duke përfshirë zotërimet e bankës në krahasim me qarkullimin normal të tregut; dhe emrin dhe praninë e vetë bankës në tregjet përkatëse.
7. Banka nuk duhet të supozojë që një treg likuid do të ekzistojë për një aset të caktuar në të gjithë skenarët e stresit thjesht sepse një treg i tillë ekziston në kohë normale. Nuk duhet të ketë pengesa ligjore, rregullatore ose operacionale për përdorimin e këtyre aseteve për të marrë fonde, pasi që

këto asete duhet të jenë të disponueshme në çdo kohë për të përmbushur nevojat e likuiditetit si dhe kur ato paraqiten.

8. Banka duhet të jetë e gatshme dhe e përgatitur për të përdorur këto asete në ngjarjet e një stresi të ashpër. Sidoqoftë, rezerva duhet të sigurojë një mbrojtje shtesë përveç vijës së parë të mbrojtjes.

### **Neni 37**

#### **Shpalosja publike**

1. Banka duhet të shpalosë publikisht informacionin rregullisht që u mundëson pjesëmarrësve të tregut të bëjnë një gjykim të informuar në lidhje me qëndrueshmërinë e kornizës së saj të menaxhimit të rrezikut të likuiditetit dhe pozicionin e likuiditetit.
2. Banka duhet të shpalosë informacion të mjaftueshëm në lidhje me menaxhimin e rrezikut të likuiditetit për të mundësuar palët e interesuara të bëjnë një gjykim të informuar në lidhje me aftësinë e bankës për të përmbushur nevojat e saj të likuiditetit.
3. Banka duhet të shpalosë strukturën e saj organizative dhe kornizën për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit. Në veçanti, shpalosja duhet të shpjegojë rolet dhe përgjegjësitë e komiteteve përkatëse, si dhe ato të njërive të ndryshme funksionale dhe të biznesit.
4. Si pjesë e raportimit të saj financiar periodik, banka duhet të sigurojë informacion sasior në lidhje me pozicionin e saj të likuiditetit që u mundëson pjesëmarrësve të tregut të formojnë një pamje të rrezikut të saj të likuiditetit.
5. Banka duhet të sigurojë shpjegim të mjaftueshëm cilësor rreth indikatorëve matës të saj për t'i bërë të mundur pjesëmarrësve të tregut t'i kuptojnë ato, p.sh. hapësira kohore e mbuluar, qoftë e llogaritur në kushte normale ose stresuese, niveli organizativ në të cilin zbatohen indikatorët matës si dhe supozime të tjera të përdorura në matjen e pozicionit të likuiditetit të bankës, rrezikut të likuiditetit dhe rezervës së likuiditetit.
6. Banka duhet të shpalosë informacione shtesë cilësore që u japin pjesëmarrësve të tregut më tepër njohuri se si ajo e menaxhon rrezikun e likuiditetit:
  - 6.1. Kjo listë është ilustruese dhe nuk kufizohet vetëm me:
    - 6.1.1. aspektet e rrezikut të likuiditetit ndaj të cilave ekspozohet banka dhe që i monitoron;
    - 6.1.2. diversifikimi i burimeve të financimit të bankës;
    - 6.1.3. teknikat tjera të përdorura për të zbutur rrezikun e likuiditetit;
    - 6.1.4. konceptet e përdorura në matjen e pozicionit të saj të likuiditetit dhe rrezikut të likuiditetit, përfshirë indikatorët matës shtesë për të cilat banka nuk i shpalosë të dhënat;
    - 6.1.5. një shpjegim se si pasqyrohet rreziku i likuiditetit të tregut të asetit në kornizën e bankës për menaxhimin e likuiditetit të financimit;
    - 6.1.6. një shpjegim se si përdoret stres testi;
    - 6.1.7. një përshkrim i skenarëve të stres testit të modeluar;
    - 6.1.8. një përmbledhje e planeve rezervë të financimit të bankës dhe një tregues se si plani lidhet me stres testin;

- 6.1.9. politika e bankës për mbajtjen e rezervave të likuiditetit;
- 6.1.10. kufizimet rregullatore për transferimin e likuiditetit ndërmjet entitetëve të grupit;
- 6.1.11. frekuenca dhe lloji i raportimit të brendshëm të likuiditetit.

## **KAPITULLI IV DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 38**

#### **Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Shkeljet e kësaj rregulloreje do të jenë subjekt i masave administrative përmirësuese dhe dënimeve të parashikuara sipas Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe Ligjit për Bankat, Institucione Mikrofinanciare dhe Institucione financiare jo-bankare.

### **Neni 39**

#### **Dispozita Kalimtare**

Bankat, jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, duhet të rishikojnë dhe/ose aprovonë politikat dhe procedurat e brendshme në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

### **Neni 40**

#### **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit e miratuar më 29.11.2012.

### **Neni 41**

#### **Hyrja në Fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë nga data e miratimit të saj.

Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës